# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 5996
E enjte, 6 shkurt 2020
çmimi 0.40 €

## Tërmeti në Shqipëri shkaktoi afro 1 miliard euro dëme

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", BELUL BEQAJ FAQE 4-5



# KURTI PO TRASHËGON PROBLEME DHE PENGESA SERIOZE

Analisti politik Belul Beqaj pret që qeveritarët e rinj të jenë më ndryshe se ata të vjetrit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se qeveria e re duhet të jetë në shërbim të qytetarëve. Beqaj ka vlerësuar se kryeministrit Kurti duhet ta fillojë eliminimin e shkaqeve dhe faktorëve që e kanë degraduar shtetin. Megjithatë, ai ka thënë se Kurti si kryeministër po trashëgon probleme dhe pengesa serioze të shtresuara ndër vite. Beqaj ka folur edhe për përbërjen e kabinetit të ri qeveritar. Sipas tij, kabineti i ri qeveritar karakterizohet me një heterogjenitet mes shumicës që do të punojë për ndryshime dhe pakicës që do të bëjë çmos për të vazhduar mentaliteti i kaluar qeverisës

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI DHE KRYEPARLAMENTARJA VJOSA OSMANI KANË PARALAJMËRUAR HEQJEN E TAKSËS NDAJ SERBISË

# PARALAJMËROHET ZËVENDËSIMI I TAKSËS ME RECIPROCITET



Qeveria e re e Kosovës pritet që taksën 100 për qind ndaj produkteve serbe ta zëvendësojë me reciprocitet të plotë politik, ekonomik e tregtar. Kështu kanë bërë me dije kryeministri Albin Kurti dhe kryeparlamentarja Vjosa Osmani. Shefi i ekzekutivit ka thënë se reciprociteti do ta shndërrojë subjektivitetin e Kosovës në çështje integriteti dhe dinjiteti. Paralajmërimin për heqje të taksës e ka kundërshtuar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) FAQE 3

## OPINION

### MALI I ZI NË GODITJEN E RE SERBE, KOSOVA DO TË JETË SHËNJESTRA E RADHËS F. 11

Milazim KRASNIQI



## AKTUALE

### KRU 'PRISHTINA' KËRKON NGA QYTETARËT TA PËRDORIN SA MË RACIONALISHT UJIN E PIJSHËM F. 8

### GRATË MË TË PUSHTETSHME NË INSTITUCIONET E REJA F. 5

### AGK-ja: KPM-ja S'KA OFRUAR ARGUMENTE BINDËSE PËR TA NDRYSHUAR KODIN ETIK F. 6

## EKONOMI

### BQK-ja KUFIZON SHPENZIMET E SIGURUESVE F. 9

### MBI 550 PUNËTORË TË KEDS-it PO SANOJNË PRISHJET NË RRJET F. 9



## SPORT

### DUMOSHI: DO TË BASHKËPUNOJMË NË INTERES TË KOMUNITETIT TË RINISË DHE SPORTIT F. 16

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Putini: Rusia bën shumë për stabilitetin në Ballkan

**Moskë, 5 shkurt** - Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, tha se vendi i tij po bën shumë për të ruajtur stabilitetin dhe sigurinë në Ballkan.
Në ceremoninë e dorëzimit të letrave kredenciale nga ambasadorët e rinj në Rusi, Putini kujtoi, siç tha ai, "takimin kuptimplotë" me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, që zhvilloi në fund të vitit të kaluar në Soçi. "Janë arritur një numër marrëveshjesh për bashkëpunimin ruso-serb në fushat e ekonomisë, tregtisë, energjisë, kulturës dhe për koordinimin në çështjet rajonale", tha Putini të mërkurën në Kremlin.
Rusinë dhe Serbinë i lidh një partneritet strategjik, që mbështetet në traditën e miqësisë, afërsisë kulturore, shpirtërore dhe historike të njerëzve, tha ai, duke shtuar se Rusia "po bën shumë për ta mbajtur situatën në Ballkan të qëndrueshme dhe të sigurt".
"Ne jemi të përkushtuar në arritjen e një zgjidhjeje për problemin e Kosovës, që do të jetë funksionalisht dhe reciprokisht e pranueshme, bazuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara", tha presidenti rus, transmeton Shërbimi i Ballkanit i "Radios Evropa e Lirë".
Në ceremoninë e së mërkurës në Moskë, letrat kredenciale i dorëzuan 23 ambasadorë të rinj, përfshirë atë të Serbisë, Miroslav Lazanski.



# Komisioni Evropian miratoi metodologjinë e re të anëtarësimit në BE

Komisionari për Zgjerim i BE-së, Oliver Varhelyi Varhelyi, tha se metodologjia e re bazohet në katër parime themelore të besueshmërisë, udhëheqjes më të fortë politike, dinamikës dhe parashikueshmërisë. "Këto janë parimet me të cilat duam të sigurojmë se procesi do të jetë më i besueshëm, më dinamik dhe i udhëhequr më shumë nga politika", tha Varhelyi




**Prishtinë, 5 shkurt** - Kolegji i Komisionit Evropian miratoi të mërkurën metodologjinë e re të procesit të anëtarësimit në BE, qëllim i së cilës është rivendosja e perspektivës së besueshme evropiane për vendet e Ballkanit Perëndimor, tha komisionari për Zgjerim i BE-së, Oliver Varhelyi.
Në konferencën me gazetarë në Bruksel, Varhelyi tha se vendet anëtare të Bashkimit Evropian duhet ta miratojnë metodologjinë e re para Samitit BE-Ballkani Perëndimor - që do të mbahet në muajin maj në Zagreb - dhe paralelisht me fillimin e negociatave të anëtarësimit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë.
Varhelyi tha se metodologjia e re bazohet në katër parime themelore të besueshmërisë, udhëheqjes më të fortë politike, dinamikës dhe parashikueshmërisë. "Këto janë parimet me të cilat duam të sigurojmë se procesi do të jetë më i besueshëm, më dinamik dhe i udhëhequr më shumë nga politika", tha Varhelyi.
Ndërsa presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, tha se Komisioni ka propozuar "plan të besueshëm dhe dinamik, i cili ia hap rrugën nisjes së negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut". "Lajm i mirë për miqtë tanë të Ballkanit Perëndimor në lidhje me procesin e zgjerimit të BE-së", shkroi von der Layen në "Twitter". Sipas dokumentit që ka parë "Radio Evropa e Lirë", metodologjia e re e bën të mundur pezullimin ose kthimin në fillim të bisedimeve të pranimit, në rastet kur vendet kandidate nuk përparojnë në asnjë fushë.
Me këtë metodologji, shtetet anëtare të Bashkimit Evropian do të kenë më shumë fuqi për të iniciuar pezullimin e negociatave të pranimit. Kjo metodologji nuk do të zbatohet për Serbinë dhe Malin e Zi - dy vende që tashmë i kanë nisur negociatat e anëtarësimit - por mbetet e hapur mundësia që edhe ato të përfshihen në qasjen e re nëse pranojnë. "Derisa përparimi në reforma duhet të inkurajohet dhe të shpërblehet në mënyrë më të prekshme, njësoj nevojitet të ketë edhe masa më vendimtare që do të sanksiononin çdo ngecje serioze ose afatgjatë ose ngecjen në zbatimin e reformave dhe plotësimin e kërkesave të procesit të pranimit", thuhet në dokument.
Metodologjia e re është iniciuar nga Franca, vitin e kaluar.
Presidenti francez, Emmanuel Macron, ka bllokuar nisjen e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, duke kërkuar reforma të mëtejshme nga këto dy vende, por edhe reformim të vetë procesit të zgjerimit të BE-së.

## Turqia i kërkon BE-së të mos e ndajë nga Ballkani Perëndimor

**Ankara, 5 shkurt** - Ankaraja kërkoi nga Bashkimi Evropian që të heqë "ndarjen artificiale" midis Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë në politikat e zgjerimit të bllokut.
Thirrja është bërë në një letër që ministri i Jashtëm turk, Mevlut Cavusoglu, ia ka adresuar shefit të politikës së jashtme të BE-së, Josep Borrell.
Letra, që është parë nga "Radio Evropa e Lirë", është e datës 22 janar dhe nënvizon pikëpamjen e Turqisë ndaj politikës së zgjerimit të BE-së. Ajo është shkruar para se Komisioni Evropian të publikonte metodologjinë e re të procesit të zgjerimit.
Kjo metodologji u publikua të mërkurën dhe u referohet vetëm vendeve të Ballkanit Perëndimor që synojnë anëtarësimin në BE.
Cavusoglu ka shkruar në letër se vendet e Ballkanit Perëndimor nuk duhet të trajtohen ndryshe nga Turqia. "Të gjitha vendet duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë. Shpresojmë të shohim disa hapa pozitivë që do t'i jepnin fund ndarjes artificiale midis Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë gjatë mandatit tuaj", ka shkruar Cavusoglu. "Përveç faktit se Turqia është një vend i Ballkanit për shkak të historisë, kulturës dhe gjeografisë së saj, çdo vend kandidat duhet të gjykohet në meritat e tij dhe në rrethana të barabarta", ka thënë Cavusoglu.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Kryeministri Albin Kurti dhe kryeparlamentarja Vjosa Osmani kanë paralajmëruar heqjen e taksës ndaj Serbisë

# Paralajmërohet zëvendësimi i taksës me reciprocitet

Qeveria e re e Kosovës pritet që taksën 100 për qind ndaj produkteve serbe ta zëvendësojë me reciprocitet të plotë politik, ekonomik e tregtar. Kështu kanë bërë me dije kryeministri Albin Kurti dhe kryeparlamentarja Vjosa Osmani. Shefi i ekzekutivit ka thënë se reciprociteti do ta shndërrojë subjektivitetin e Kosovës në çështje integriteti dhe dinjiteti. Paralajmërimin për heqje të taksës e ka kundërshtuar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)



EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 5 SHKURTI - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, kanë paralajmëruar zëvendësimin e taksës 100 për qind ndaj produkteve serbe me reciprocitetin e plotë politik, ekonomik e tregtar. I pari i qeverisë ka thënë se në Kosovë ekziston një mendim i përgjithshëm për vendosje të reciprocitetit me Serbinë. "Jemi këtu ku jemi si qeveri e re edhe për shkak të zotimit tonë që me Serbinë do të kemi reciprocitet ekonomik, politik e tregtar, si zëvendësim të tarifës 100 për qind", ka thënë Kurti në një konferencë për medie pas takimit me përfaqësuesen e Bashkimit Evropian në Kosovë, Nataliyia Apostolova.

Sipas tij, reciprociteti do ta forconte subjektivitetin e shtetit të Kosovës ndaj Serbisë. "Pra, ne nuk themi që do të kthehemi në marrëdhënie asimetrike me Serbinë, përkundrazi do të avancojmë duke e shndërruar subjektivitetin tonë në çështje integriteti e dinjiteti, me parimin i cili më së shumti njihet për vlerën e tij në raportet ndërfqinjësore e bilaterale, e ky është reciprociteti", është shprehur Kurti. Sipas tij, edhe Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Lëvizja Vetëvendosje janë praktikisht për parimin e reciprocitetit. "Besoj se edhe ata që janë në opozitë dhe që nuk na votuan, mund të mos pajtohen me mua për gjëra të ndryshme, por për reciprocitetin do të jenë dakord", ka deklaruar Kurti.

Edhe kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka përmendur mundësinë e zëvendësimit të taksës 100 për qind me reciprocitet. Ajo ka thënë se kjo duhet të ndodhë pas ndërprerjes së fushatës së Serbisë ndaj shtetit të Kosovës. "Programi i përbashkët i koalicionit është prezantuar nga kryeministri Albin Kurti në Kuvend më 3 shkurt dhe aty është bërë e qartë se, siç e kemi thënë, tarifa të zëvendësohet me masat e reciprocitetit. Për t'u larguar kjo tarifë, siç edhe e ka thënë ambasadori amerikan Grenell, Serbia duhet ta ndërpresë fushatën e çnjohjeve që po bën përmes metodave ilegale, që e ka minuar rëndësinë e dialogut", ka deklaruar Osmani pas takimit me ambasadorin e Gjermanisë në Prishtinë, Christian Held.

Paralajmërimin për heqje të taksës e ka kundërshtuar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

Nënkryetari i këtij subjekti politik, Muharrem Nitaj, ka thënë se heqja e taksës pa njohjen e Kosovës është dorëzim përballë Serbisë. "Heqja e taksës pa njohje është dorëzim përpara Serbisë. Reciprociteti është me u qit hi syve. Eksporti i Kosovës në Serbi është qesharak krahasuar me miliardat e mallrave serbe që do të hyjnë në Kosovë!", ka thënë Nitaj.

Ndërkaq shefja e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Nataliya Apostolova, ka vlerësuar se vendosja e taksës ka qenë veprim i gabuar dhe se ajo duhet të hiqet. "Konsiderojmë që taksa ka shkelur bashkëpunimin ndërkombëtar dhe marrëveshjet e tjera si CEFTA, anëtare e së cilës është Kosova. Tani po presim që qeveria e re të dalë me propozime dhe ide të reja se si do ta trajtojë këtë çështje. Nuk dëshirojmë të parashohim se cila do të jetë zgjidhja, vetëm dëshirojmë që këto bisedime të vazhdojnë, në mënyrë që për ne është e rëndësishme që dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë të fillojë", ka thënë Apostolova pas takimit me kryeministrin Kurti.

Një ditë pasi që Kuvendi i Kosovës ka votuar për formimin e qeverisë së re me Albin Kurtin kryeministër, i dërguari i Shtëpisë së Bardhë për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell, i ka bërë thirrje Qeverisë së re të Kosovës që ta heqë taksën ndaj mallrave të importuara nga Serbia.

Taksa doganore 100 për qind ndaj importeve nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina ishte vendosur në nëntorin e vitit 2018, nga Qeveria e kaluar e Kosovës e ish-kryeministrit Ramush Haradinaj. Ky vendim i qeverisë së kaluar ishte parë më pas si pengesë për vazhdimin e dialogut midis Prishtinës dhe Beogradit, pasi që presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ishte tërhequr nga tavolina e bisedimeve, duke e kushtëzuar vazhdimin e dialogut me heqjen e taksës.

# Një grup studentësh numërojnë shkeljet e Kurtit dhe të Osmanit në ditën e dytë të marrjes së detyrës







PRISHTINË, 5 SHKURT (ER) - Një grup studentësh të Universitetit të Prishtinës kanë mbajtur fjalim të mërkurën para Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës, përkatësisht për dy krerët e porsazgjedhur.

Djellza Gashi ka thënë se Albin Kurti të martën qëndroi para flamurit të Kosovës që dikur e quante lara-lara. Ajo më tej ka thënë se Kurti i përbuzi simbolet e shtetit. "Sot jemi mbledhur këtu si studentë dhe të rinj për një aksion simbolik me dy mesazhe të qarta për dy bartësit e institucioneve. Albin Kurti me dekada i mohoi institucionet dhe simbolet e Kosovës, i përbuzi ato dhe i përdhosi në ujëra të zeza dhe i dogji me molotov. Ai qëndroi dje gatitur para flamurit të Republikës së Kosovës që e quante flamur lara-lara apo flamur i 'Hib Petrol'-it. Me sjelljet e tij politike me gaz lotsjellës në Kuvend, me përdorimin e dhunës në rrugë e me ngritjen e tendave e të greva në shesh e ka gjuajtur iluzionin, nuk bëhet dhe Kosova është shtet i dështuar. Ishin përpjekjet e tij për ta përmbysur shtetin tonë", ka thënë ajo.

Ndërkaq, studentja Majlinda Selmanaj ka potencuar se edhe kryeparlamentarja qysh në ditën e parë ka shkelur Kushtetutën dhe ligjin duke hequr fotografinë e presidentit Hashim Thaçi. "Ligji për protokollin e shtetit i obligon institucionet ta vendosin flamurin e presidentit. Vjosa Osmani qysh në ditën e parë e shkeli Kushtetutën dhe ligjin. Ajo tha se e njeh mirë legjislacionin dhe të njëjtën gjë e kishte thënë tek ish-presidenti Fatmir Sejdiu i cili ka dhënë dorëheqje pasi ajo nuk e ka këshilluar si duhet. Sipas ligjit, fotografia e presidentit duhet të vendoset në vend të dukshëm dhe ballor. Ata duhet të dinë se pozitat janë të përkohshme dhe institucionet e përhershme", ka thënë studentja Selmanaj.

Flet për "Epokën e re", Belul Beqaj

# Kurti po trashëgon probleme dhe pe



**Analisti politik Belul Beqaj pret që qeveritarët e rinj të jenë më ndryshe se ata të vjetrit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se qeveria e re duhet të jetë në shërbim të qytetarëve. Beqaj ka vlerësuar se kryeministri Kurti duhet ta fillojë eliminimin e shkaqeve dhe faktorëve që e kanë degraduar shtetin. Megjithatë, ai ka thënë se Kurti si kryeministër po trashëgon probleme dhe pengesa serioze të shtresuara ndër vite. Beqaj ka folur edhe për përbërjen e kabinetit të ri qeveritar. Sipas tij, kabineti i ri qeveritar karakterizohet me një heterogjenitet mes shumicës që do të punojnë për ndryshime dhe pakicës që do të bëjë çmos për ta vazhduar mentalitetin e kaluar qeverisës**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 5 SHKURT - Njohësi i rrethanave politike, Belul Beqaj, shpreson që qeveritarët e rinj të mos jenë sikurse ata të kanë qenë më herët. Ai ka deklaruar se qeveritarët e rinj duhet të jenë në shërbim të qytetarëve. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Beqaj ka treguar se qeveria e re duhet ta fillojë eliminimin e shkaqeve dhe faktorëve që e kanë degraduar shtetin. "Besoj se do të filloj diskontinuiteti me pushtetin e kapur. Do të fillojë eliminimi i shkaqeve dhe faktorëve që e kanë degraduar shtetin dhe e kanë tretur shpresën se, megjithatë, Kosova nuk është shtet i pa shpresë! Prandaj, shpresoj së pushtetarët do të jenë në shërbim të qytetarëve e jo të shërbehen me ta siç ka ndodhur deri më tani", ka thënë Beqaj. Ai ka folur edhe për përbërjen e kabinetit të ri qeveritar, i cili do t'i ketë 15 ministra dhe dy zëvendëskryeministra.

Beqaj ka vlerësuar se ky kabinet qeveritar karakterizohet me një heterogjenitet mes shumicës që do të punojnë për ndryshime dhe pakicës që do të bëjë çmos për ta vazhduar mentalitetin e kaluar qeverisës. "Kabinetin qeveritar e karakterizon heterogjeniteti mes shumicës që do të punojë për ndryshime në krye me Albinin, pakicës që do të bëjë çmos për të vazhduar mentaliteti i "shtetit të kapur" në krye me Agimin Veliun dhe të tjerëve që do të sprovohen ndaj liderëve dhe detyrave ministrore!", është shprehur Beqaj.

Më tej, njohësi i rrethanave politike ka treguar për vështirësitë me të cilat do të përballet qeveria e re. Ai ka thënë se kryeministri Kurti do të trashëgojë probleme dhe pengesa serioze të shtresuara nder vite. Sipas Beqajt, vështirësitë që do të dalin me konsolidimin e qeverisë do të jenë arsye që perfomanca e Kurtit në vitin e parë do të jetë nën kapacitetin dhe vullnetin subjektiv. Analisti politik ka folur edhe për opozitën e re, duke paralajmëruar se ajo nuk do të jetë destruktive. "Opozita në mënyrë shumë të tejdukshme u mundua, duke akuzuar LV-në dhe Albinin, ta mbrojë të kaluarën e errët. Prandaj, nuk pres konstruktivitet. Përkundrazi, mobilizimi kryesisht destruktiv i opozitës po paralajmëron destabilizim sa për shkak të kryeministrit dhe koalicionit të pasprovuar, edhe më shumë të frikësuar nga ngritja e aktakuzave të Gjykatës Speciale", ka thënë Beqaj.

**"Epoka e re":** *Z. Beqaj, koalicioni qeverisës LV-LDK u bë dhe qeveria Kurti u votua në Kuvend. Si e shihni z. Kurti si kryeministër?*

**Beqaj:** Periudha kohore derisa më në fund u arrit marrëveshja na ka përkujtuar më shumë në logjikën e pushteteve të "shtetit të kapur" sesa të partnerëve të përcaktuar për ndryshim. Kurti si kryeministër po trashëgon probleme dhe pengesa serioze

# ngesa serioze



të shtresuara ndër vite. Vështirësitë që do të dalin me konsolidimin e qeverisë, vështirësitë me partnerin dhe mungesa e përvojës vendimmarrëse politike do të jenë arsye që perfomanca e tij, në vitin e parë, do të jetë nën kapacitetin dhe vullnetin subjektiv.

**"Epoka e re":** *Cilat janë pritjet tuaja nga qeveria e re?*

**Beqaj:** Besoj se do të fillojë diskontinuiteti me pushtetin e kapur. Do të fillojë eliminimi i shkaqeve dhe faktorëve që e kanë degraduar shtetin dhe e kanë tretur shpresën se, megjithatë, Kosova nuk është shtet i pa shpresë! Prandaj, shpresoj se pushtetarët do të jenë në shërbim të qytetarëve e jo të shërbehen me ta, siç ka ndodhur deri më tani.

**"Epoka e re":** *Ky kabinet qeveritar do të jetë më i vogël në numër dhe me figura kryesisht të paprovuara në ekzekutiv. Cili është vlerësimi juaj për përbërjen e kabinetit qeveritar?*

**Beqaj:** Kabinetin qeveritar e karakterizon heterogjeniteti mes shumicës që do të punojë për ndryshime në krye me Albinin, pakicës që do të bëjë çmos për të vazhduar mentaliteti i "shtetit të kapur" në krye me Agimin Veliun dhe të tjerëve që do të sprovohen ndaj liderëve dhe detyrave ministrore.

**"Epoka e re":** *Dialogu me Serbinë do të jetë prej temave të para dhe kryesore me të cilat do të merret kjo qeveri. I dërguari special i presidenti Trump ka paralajmëruar dinamikë të re të këtij procesi. Çka do të ndodhë me këtë proces gjatë qeverisë së re?*

**Beqaj:** Derisa të mos arrihet dhe qartësohet qëndrimi unik ndërkombëtar për zgjidhjen përfundimtare ligjërisht obligative të marrëveshjes me Serbinë, besoj se Kosova prioritet më të madh e ka gjendjen e vështirë ekonomike, drejtësinë, arsimin dhe shëndetësinë. Së pari, ata që insistojnë që dialogu të jetë çështje urgjente, në fakt, do të rrënojnë me shpejtësi urgjente këtë qeveri me probleme të trashëguara dhe pa u konsoliduar funksionalisht. Së dyti, pa u normalizuar marrëdhëniet i dërguari special amerikan nuk do ta zgjidhë problemin përmbajtësish, eventualisht, vetëm formalisht!

**"Epoka e re":** *Në ditën e votimit të Kurtit në Kuvend e pamë një reagim të ashpër të opozitës ndaj kryeministrit të ri. Prisni të jetë konstruktive kjo opozitë?*

**Beqaj:** Reagimi i opozitës, veçmas ndaj LV-së ka qenë plot mllef, akuza, ofendime, shpifje, kërcënime, aty-këtu edhe me kritika dashamirëse dhe të qëndrueshme. Por, edhe sikur të gjitha diskutimet të ishin të argumentuara për atë çfarë ka bërë LV-ja dhe Kurti duke qenë në opozitë, nuk mund të barazohen as me një vit të keqpërdorimeve aksiomatike të pushteteve të deritanishme! Opozita në mënyrë shumë të tejdukshme u mundua, duke akuzuar LV-në dhe Albinin, ta mbrojë të kaluarën e errët! Prandaj, nuk pres konstruktivitet. Përkundrazi, mobilizimi kryesisht destruktiv i opozitës po paralajmëron destabilizim sa për shkak të kryeministrit dhe koalicionit të pasprovuar, edhe më shumë të frikësuar nga ngritja e aktakuzave të Gjykatës Speciale!

# Gratë më të pushtetshme në institucionet e reja

**Prishtinë, 5 shkurt** - Për herë të parë që nga formimi i institucioneve të Republikës së Kosovës, në qeverinë e re të drejtuar nga Albin Kurti, që përbëhet nga 15 ministri, pesë prej tyre do to udhëhiqen nga gratë. Ndërkohë, në krye të Kuvendit të Kosovës është zgjedhur, po ashtu, një grua, Vjosa Osmani, e cila zëvendëse të parë ka, po ashtu një grua, deputeten Arbërie Nagavci.

Ministret gra të votuara të hënën në Kuvendin e Kosovës janë Albulena Haxhiu, ministre e Drejtësisë, Rozeta Hajdari, ministre e Ekonomisë, Tregtisë dhe Financave, që të dyja nga Lëvizja Vetëvendosje.

Ndërkaq nga Lidhja Demokratike e Kosovës, Hykmete Bajrami, është emëruar ministre e Arsimit dhe Vlora Dumoshi, ministre e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Kurse, nga komunitetet joserbe, Emilia Rexhepi, do të jetë ministre e Administrimit të Pushteti Lokal.

Organizatat joqeveritare që merren me të drejtat e grave dhe fuqizimin e rolit të tyre në politike dhe shoqëri, e vlerësojnë si hap pozitiv emërimin e gjashtë grave në pozita vendimmarrëse, pasi disa herë kanë shprehur shqetësime se gratë janë të nënpërfaqësuara në shumicën e posteve udhëheqëse.

Luljeta Demolli, drejtoreshë ekzekutive në Qendrën për Hulumtime dhe Studime Gjinore, në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë", ka thënë se në qeverinë e re është arritur kuota prej 30 përqindësh çka, sipas saj, nënkupton se sistemi i kuotave ka dhënë efekte pozitive. "Realisht edhe kryeministri (Albin Kurti), edhe kryetarja e Kuvendit (Vjosa Osmani) kanë ardhur nga gjeneratat e reja. Prandaj, është normale që të kemi një përfaqësim më të mirë sa i përket përfaqësimit gjinor. Po ashtu, kemi një përfaqësim të grave mjaft kualitativ. Me këtë shpresojmë se kjo qeveri të jetë më e gatshme që ta rrisë edhe numrin e grave në punësim", ka deklaruar Demolli.

Edhe Jeta Krasniqi, analiste nga Instituti Demokratik i Kosovës, ka theksuar për "Radion Evropa e Lirë" se rritja e përfaqësimit të grave në qeverinë e re dëshmon se vullneti politik është në përputhje më kërkesat e organizatave joqeveritare dhe nevojën që të gjithë anëtarët e shoqërisë t'i marrin obligimet e tyre si pjesëtarë të barabartë.

"Më këtë mendoj se do të rritet edhe vetëdijesimi i shoqërisë për rolin e grave që kanë në përgjithësi, si në shoqëri, vendimmarrje dhe çdo fushë të jetës. Përveç rritjes së vetëdijesimit, do të luftohen edhe paragjykimet gjinore", tha Krasniqi. Përveç emërimeve në qeveri, në zgjedhjet parlamentare të 6 tetorit, gratë siguruan 38 nga 120 ulëse sa ka Kuvendi i Kosovës. Shumica e grave deputete siguruan ulëset në kuvend përmes votave të fituara, pa pasur nevojë për kuotë gjinore.

Sistemin e kuotave në Kosovë për herë të parë e pati aplikuar Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) në vitin 2000. Në bazë të një rregulloreje, kërkohej që së paku 30 për qind të kandidatëve në listat e partive të jenë të gjinisë femërore.

Por, përfaqësuese nga shoqëria civile thonë se duhet të zbatohet Ligji për barazi gjinore, në të cilin thuhet se "përfaqësimi i pabarabartë - është atëherë kur pjesëmarrja apo përfaqësimi i njërës gjini, është më i ulët se 50 për qind në çdo organ dhe nivel vendimmarrës në jetën politike dhe publike".

Në qeverinë e udhëhequr nga Ramush Haradinaj, e formuar në vitin 2017 dhe e cila numëronte 21 ministri, fillimisht ishin emëruar vetëm dy gra në poste ministrore, Dhurata Hoxha dhe Albena Reshitaj. Kjo e fundit një vit më vonë kishte dhënë dorëheqje.

Gjatë mandatit të së njëjtës qeveri, pas disa ndryshimeve në ministri, Adrijana Hoxhiq kishte drejtuar Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, kurse në fillim të vitit të kaluar, Dijana Zhiviq ishte emëruar ministre e Bujqësisë.

Një çështje tjetër që në vazhdimësi është ngritur si shqetësim, sa i përket përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje, ndërlidhet me pushtetin lokal, pasi që të 38 komunat e Kosovës udhëhiqen nga burrat.

Pozita më e lartë e mbajtur ndonjëherë nga ndonjë grua në Kosovë është ajo e presidentes së Kosovës nga Atifete Jahjaga, nga viti 2011 deri në vitin 2016.

Në një raport statistikor për vitin 2019 të Institutit për Studime të Avancuara GAP, të publikuar javën e kaluar, thuhet se shkalla e punësimit të grave, sidomos në pozita të larta udhëheqëse, mbetet shumë e ulët në krahasim me burrat. Këto dallime janë më të shprehura sidomos në nivelin qendror. Sipas këtij raporti, deri në ditën e dorëheqjes së kryeministrit Haradinaj, vetëm dhjetë për qind të posteve të larta drejtuese (ministra, zëvendësministra, sekretarë të përgjithshëm) menaxhoheshin nga gratë. Edhe në pozitat drejtuese në administratën komunale, theksohet në raportin e GAP-it, përfaqësimi i grave mbetet mjaft i ulët, me vetëm 20 për qind. Përveç në pozita drejtuese, në përgjithësi, shkalla e grave të punësuara mbetet më e ulët se e burrave. Përderisa shkalla e papunësisë te burrat, më 2019, ishte 22.8 për qind, shkalla e papunësisë te gratë ishte 32.7 për qind.

Në anën tjetër, thuhet në raport, interesimi i grave për të gjetur një vend pune është gati i të njëjtit nivel me atë të burrave.



# Kosova dhe Britania e Madhe do të kenë raporte të shkëlqyeshme edhe pas Brexit-it

PRISHTINË, 5 SHKURT (ER) - Ministri i Punëve të Jashtme i Republikës së Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të mërkurën në takim ambasadorin e Britanisë së Madhe në Prishtinë, Nicholas Abbott. Në këtë takim miqësor ministri Konjufca dhe ambasadori Abbott biseduan edhe për zhvillimet politike në Kosovë, rajon dhe më gjerë.

Ministri Konjufca ka shprehur gatishmërinë e tij për t'i vazhduar marrëdhëniet e shkëlqyeshme në mes dy vendeve, Republikës së Kosovës dhe Britanisë së Madhe, edhe pas Brexitt (largimit të Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore nga Bashkimi Evropian). Edhe ambasadori britanik Abbott ka shprehur gatishmërinë e tij dhe të Mbretërisë së Bashkuar për ta vazhduar mbështetjen dhe qëndrimin pranë Republikës së Kosovës në të gjitha proceset e rëndësishme të saj.



# Ministrja Bajrami i ofron bashkëpunim SBAShK-ut

EPOKA E RE Qendresa RAMA



PRISHTINË, 5 SHKURT - Në ditën e dytë të angazhimeve në detyrën e re, ministrja e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë (MAShT), Hykmete Bajrami, e shoqëruar nga këshilltari i lartë, Lulëzim Krasniqi, ka vizituar selinë e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBAShK).

Duke shprehur kënaqësinë në emër të të gjithë anëtarësisë për këtë vizitë, kryetari i SBAShK-ut, Rrahman Jasharaj, bashkë me nënkryetaren Vjollca Shala dhe menaxherin për Financa e administratë dhe koordinator për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri, kanë informuar ministren Bajrami për sfidat dhe angazhimet aktuale, duke shprehur gatishmërinë për angazhime të përbashkëta me MAShT-in në shërbim të arsimit, përmirësimit të kushteve të punës në institucionet e arsimit dhe për ngritjen e vazhdueshme të cilësisë në arsim.

Në takimin e parë me ministren Bajrami, përfaqësuesit e SBAShK-ut kanë kërkuar që të punohet lidhur me çështjen e punëtorëve të arsimit me bachelor, e që janë në sistemin arsimor, në mënyrë që të gjendet zgjidhje e pranuar për ta.

Po në këtë takim përfaqësuesit e SBAShK-ut kanë kujtuar se kjo sindikatë gjithmonë është angazhuar që çështjet të zgjidhen me dialog, por kur pala tjetër nuk ka reflektuar atëherë, sipas tyre, kanë ndodhur edhe grevat të cilat nuk kanë qenë dhe nuk janë dëshirë e SBAShK-ut, por veprohet duke respektuar zërin e të punësuarve në arsim.

Më tutje, ata kanë kërkuar që të ketë takime të përbashkëta të MAShT-it, drejtorive komunale të arsimit dhe SBAShK-ut për të debatuar shtruar për të gjithë çështjet në arsim dhe për të bërë angazhime të përbashkëta për tejkalimin e problemeve dhe sfidave.

Ndërsa ministrja e MAShT-it, Hykmete Bajrami, ka thënë se ka mjaft njohuri për punën dhe angazhimet e SBAShK-ut. Ajo ka thënë se për shkak të respektit ndaj SBAShK-ut ka vendosur që në ditën e dytë të angazhimit në detyrën e ministres ta vizitojë këtë sindikatë. Ministrja Bajrami ka deklaruar se të gjitha çështjet e lidhura me arsimin në Kosovë do të diskutohen bashkërisht. Sipas saj, vetëm bashkërisht dhe me angazhime të sinqerta do të zgjidhen kërkesat e punëtorëve të arsimit si dhe do të ngritët cilësia në arsim.

# AGK-ja: KPM-ja s'ka ofruar argumente bindëse për ta ndryshuar Kodin Etik

PRISHTINË, 5 SHKURT (ER) - Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK), ndonëse me vonesë ka pranuar përgjigje nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM) lidhur me shqetësimet e ngritura ditë më parë rreth propozimit të KPM-së për ndryshimin e draft-kodit të etikës për ofruesit e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuele në Republikën e Kosovës dhe të draft-rregullores për mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audio dhe audiovizuele, vlerëson se të dyja dokumentet përmbajnë nene problematike të cilat cenojnë lirinë e shprehjes së gazetarëve dhe lirinë e medies. "Në veçanti, ne jemi të shqetësuar me draft-kodin e etikës i cili rikthen ndalimin e raportimit nga gjykatat. Ju rikujtojmë se Kodi i Etikës i vitit 2010 e ndalonte në tërësi raportimin nga gjykata. Kodi i Etikës i vitit 2016, që është ende në fuqi dhe është hartuar me ekspertizë ndërkombëtare, kishte eliminuar nenet që pengonin raportimin nga gjykatat. Me draft-kodin e etikës KPM-ja ka rikthyer ndalimin e raportimit nga gjykatat", ka njoftuar AGK-ja.




Ky asociacion ka theksuar se vazhdojnë të kenë shqetësime për disa nga nenet e propozuara në draft-rregulloren e lartpërmendur. "Në letrën e KPM-së të nënshkruar nga kryeshefi ekzekutiv i saj, Luan Latifi, nuk janë ofruar argumente të mjaftueshme ligjore që do ta arsyetonin ndryshimin e Kodit të Etikës apo draft-rregullores. Letra si e tillë nuk ofron referencë të rasteve konkrete të shkeljeve etike në media të monitoruara nga KPM-ja, të cilat raste do të dëshmonin që mediet nuk kanë mundur të mbahen përgjegjëse për shkak të mungesës së bazës ligjore. Tutje, mbetet ende e paqartë nëse KPM-ja ka bërë ndonjë analizë ligjore si lloj vlerësimi ex-post për t'i vlerësuar objektivat, efektet e ndërmarra, kostot dhe përfitimet e akteve nënligjore në fuqi. Ajo, po ashtu, nuk tregon se në cilat standarde ndërkombëtare është bazuar kur ka propozuar ndryshimet ligjore dhe, po ashtu, KPM-ja pranon që nuk ka kërkuar ekspertizë ligjore ndërkombëtare, të cilën mekanizëm e ka në dispozicion", ka njoftuar ky asociacion, duke shtuar se KPM-ja nuk ka argumente bindëse në raport me këto ndryshime. "Në një situatë të tillë, kur kemi mungesë të argumenteve ligjore bindëse nga ana e KPM-së, aktet nënligjore të përmendura më sipër, sipas nesh, nuk duhet të amandamentohen duke u nxituar. Ndryshimet ligjore, siç janë propozuar aktualisht, të kundërshtuara fuqishëm edhe nga organizatat kryesore të shoqërisë civile, do ta cenojnë seriozisht lirinë e shprehjes dhe lirinë e medieve në Kosovë. AGK-ja së bashku me znj. Flutura Kusari siguron KPM-në se do të angazhohet në konsultimet publike të akteve nënligjore të KPM-së në rastet kur ne pajtohemi në parim me qëllimin e akteve nënligjore. Po ashtu, kërkojmë nga KPM-ja që të iniciojë vlerësim ex-post të akteve nënligjore për t'i identifikuar efektet e akteve nënligjore, problemet eventuale të zbatimit dhe aspektet që duhet të rishqyrtohen", ka njoftuar AGK-ja.

# Haradinaj: Qeveria e re t'i përmbahet interesit kombëtar

Ish-kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se qeverinë e re e presin plot sfida, se një ndër to është dialogu me Serbinë. Ai ka pohuar se sfida kryesore e qeverisë së re është t'i ruajë parametrat që ka vendosur qeveria nën drejtimin e tij në temat e interesit kombëtar



PRISHTINË, 5 SHKURT - Ish-kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se formimi i qeverisë së re është lajm i mirë për Kosovën. Ai ka theksuar për "Zërin e Amerikës" se qeverinë e re e presin plot sfida dhe kryesorja është "t'i ruajë parametrat që ka vendosur qeveria përpara saj në temat e interesit kombëtar".
Në këtë intervistë Haradinaj ka folur për çështjen e taksës 100 për qind ndaj mallrave serbe, duke thënë se taksa nuk duhet të hiqet, por të ndërlidhet me njohjen, jo me reciprocitetin.
Haradinaj ndodhet në ShBA për të marrë pjesë në dy forume për çështjet e sigurisë si dhe për një takim në Departamentin e Shtetit. "Kemi bërë zgjedhjet më të mira të mundshme në rajon dhe në Kosovë se ndonjëherë më parë. Tanimë u implementua edhe rezultati i zgjedhjeve. Pra, kemi qeverinë e re. Është lajm i mirë për Kosovën. E presin plot sfida qeverinë e re. Sfida kryesore është t'i ruajë parametrat që ka vendosur një qeveri përpara saj në temat e interesit kombëtar, pra qeveria që kam pasur nderin të udhëheq", ka thënë Haradinaj.
Duke folur për dialogun Kosovë - Serbi, Haradinaj ka thënë se ky proces nuk është ndërprerë për shkak të taksës por, sipas tij, Serbia ka mbajtur një qasje të dyfishtë dhe është ulur në tavolinë me idenë që t'i joshë deri në ndarjen e Kosovës. "Ndërsa në të njëjtën kohë, ka vazhduar intensivisht ta dobësojë Kosovën në planin ndërkombëtar, pra ta sulmojë. Njëkohësisht edhe të na rrezikojë në planin e brendshëm. Tarifa ka qenë si masë mbrojtëse ndaj veprimeve agresive të Serbisë që kanë rrezikuar deri edhe tërësinë territoriale, sovranitetin e Kosovës. Për fat të mirë, Kosova është shumë më e fortë sot. Ka ushtrinë e vet. Ka sistemin e sigurisë të konsoliduar dhe ka rend dhe ligj në të gjithë vendin", është shprehur ai.
Ish-kryeministri Haradinaj ka pohuar se, pavarësisht vendosjes së taksës ndaj Serbisë, Kosova nuk i ka prishur raportet me aleatët, veçanërisht me ShBA-në. "Kurrë nuk i ka pasur Kosova më të mira marrëdhëniet, p. sh. me Amerikën. Ne, p. sh., punojmë në rrugë dypalëshe në planin e sigurisë", ka theksuar Haradinaj.
Ai ka shtuar se kushdo që flet për ndarje të Kosovës është shpallje lufte. "Është me shumë rëndësi që Kosova e ka penguar diskutimin ose debatin për ndarjen e vetvetes. Është shpallje lufte. Është agresion. Kushdo që flet për ndarjen e vendit tim, në rastin konkret, kushdo që ma përmend ndarjen, ai po i shpall luftë vendit tim. Kjo temë ka kaluar. I kemi kaluar edhe disa tema të tjera", është shprehur ish-kryeministri Haradinaj.
Ai ka shprehur optimizëm se presidenti Donald Trump dhe ambasadori Richard Grenell do të ndihmojnë që gjatë këtij viti të kemi një marrëveshje për njohje reciproke obliguese ligjore Kosovë - Serbi. "Serbia do të kërkojë diçka tjetër. I kisha lutur mos ta bëjnë këtë gabim. Mos ta heqin taksën, por ta ndërlidhin taksën me njohjen, jo me reciprocitetin. Është gabim logjika e tyre e reciprocitetit", ka deklaruar Haradinaj.

# Tërmeti në Shqipëri shkaktoi afro 1 miliard euro dëme

TIRANË, 5 SHKURT - Tërmeti i 26 nëntorit në Shqipëri shkaktoi dëme në vlerë prej 985 milionë eurosh, ndërsa ndikoi edhe në ngadalësimin e rritjes ekonomike, thanë zyrtarë të këtij vendi.
Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Bledi Çuçi, tha se shifrat janë hartuar në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian, Bankës Botërore dhe Kombeve të Bashkuara për fatkeqësitë natyrore në të gjithë botën.
Tërmeti me fuqi prej 6.4 shkallësh të rihterit la 51 njerëz të vdekur dhe qindra të lënduar. Në total, 202 291 njerëz në 11 komuna janë prekur nga katastrofa, tha Çuçi në një konferencë në Tiranë.
Sipas tij, autoritetet kanë kontrolluar rreth 50 000 ndërtesa të dëmtuara.
Menaxherja e Bankës Botërore në Shqipëri, Evis Sulko, tha se tërmeti ka shkaktuar dëme që kapin vlerën e gjithsej 7.5 për qind të bruto prodhimit të brendshëm të Shqipërisë dhe se ka bërë që ekonomia të ngadalësohet. "Shkalla e rritjes ekonomike në fund të vitit të kaluar ka qenë në rënie dhe kjo trajektore është parashikuar edhe për këtë vit", ka thënë Sulko.
Parashikimi i rritjes ekonomike për 3.5 për qind ka rënë tani në 3.2 për qind.
Bashkimi Evropian planifikon të mbajë një konferencë donatorësh më 17 shkurt për ta ndihmuar Shqipërinë për trajtimin e pasojave të tërmetit.



# Ajo çfarë klientët duan përtej respektit dhe kuptimit



Gentrit KADROLLI

Kemi dëgjuar shpeshherë që e gjithë ajo çfarë klientët duan është që të jenë të respektuar, të mos diskriminohen, por edhe të jenë të mirëkuptuar nga ata që u shërbejnë. Këto tri elemente, fatkeqësisht, për një pjesë të konsiderueshme të bizneseve në vendin tonë mbeten ende edhe sot kërkesa të tyre elementare, gjë që nuk do të duhej të ishin. Në ditët e sotme ndodh që ende stafit shërbyes të klientëve t'i mbahen trajnime të përsëritura se si të respektohet klienti, se si të kuptohet ai dhe se si të mos vërehen në sy të klientit si diskriminues ndaj tij. Shumë e drejtë.

Por...

Të dimë se si t'i respektojmë klientët dhe t'i bëjmë të kuptojnë se qëllimi nuk është t'i diskriminojmë ata, janë aftësi shumë të rëndësishme, por të pamjaftueshme për qëndrueshmërinë e biznesit dhe realizimin e një shitje në mënyrën më të mirë të mundshme nëse nuk ju bashkëngjiten edhe aftësitë profesionale.

### Ajo çka klientët duan por nuk duan ta thonë

Nga disa studime të mëparshme që janë bërë në këtë drejtim del që në momentin e hyrjes së klientit brenda në një biznes, emocioni i tij blerës rritet deri 30 %. Pra, emocioni i tij blerës ka filluar të aktivizohet, por nuk varet e gjitha prej tij se a do të përfundojë i "blershëm". Nevojitet ndihma e faktorit njeri, apo thënë më ndryshe e stafit shitës të biznesit që të përfundohet blerja. Përpos elementeve të lartcekura të cilat janë shumë të vlefshme, tani nevojiten pikërisht ato aftësi profesionale të cilat do ta bëjnë klientin të blejë. Dëshira e klientëve është që të blejnë, por arsyet që ata frikësohen të realizojnë blerje mund të jenë të ndryshme nga e kaluara e tyre, kurse në anën tjetër frika e tyre rritet edhe më shumë kur stafi shërbyes, respektivisht shitësit, bien në kurthin e 7-të të ligjit të xhunglës së biznesit të blerjes dhe shitjes, i cili ligj thotë që nëse klienti e vëren që shitësi me çdo kusht dëshiron ta shesë produktin e tij, ai nuk do ta blejë atë. Ajo çka klientët duan, por nuk jua thonë është: kur klientit nuk i përshtatet një produkt nga mënyra e funksionit të atij produkti, ai kërkon alternativa të tjera dhe jo të bëhemi të shtangur në vend. Ajo çfarë klientët duan, por nuk jua thonë është kur ata kanë vërejtjet e tyre rreth çmimit të produktit, ne nëpërmjet njohjes së produktit tonë t'i tregojmë vlerat e produktit dhe përfitimet që do t'ia sjellë klientit ai produkt, kurse çmimi të mbetet në mes të dyjave, që do të thotë çmimi të jetë i barasvlershëm, sipas tyre, me vlerat dhe përfitimet që do t'i ketë klienti nga ai produkt. Ajo çka klientët duan, por nuk jua thonë është që edhe nëse kanë vendosur të bëjnë shëtitje siç bëjnë shpesh nëpër butikë apo qendra tregtare, është e domosdoshme t'u bëhet e qartë që jemi aty në shërbim edhe të atyre që vetëm kanë dalë për të hulumtuar /krahasuar produktet. Ajo çka klientët duan, por nuk jua thonë, është që çdo element që diskutohet të jetë i konfirmuar dhe jo të dalë e kundërta kur të bëhet një përmbledhje pothuajse në fund pak para se të realizohet blerja. Ajo çka klientët duan, por nuk jua thonë, është që të mos ngelemi te një opsion, por t'i ofrohen dy zgjidhje, kurse nëse dëshirojmë ta forcojmë mendimin e klientit për njërin produkt, t'i ofrojmë tri zgjedhje. Ajo çfarë klientët duan, por nuk jua thonë, është që edhe nëse të refuzojnë në fillim, apo thjesht përgjigjja e tyre është "jo, nuk mundem", refuzimi për stafin shitës nuk do duhej të nënkuptohej që nuk bën të vazhdohet më tutje, por që nënkupton ende paqartësi për klientin dhe ka nevojë për dhënien e shpjegimeve shtesë për ta.

Ajo çka klientët duan, por nuk jua thonë, është që edhe pse blerja është realizuar, jo të harrohet ai klient derisa të vijë dhe të blejë prapë, por ai klient pas blerjes të përcillet apo të pyetet qoftë fizikisht, përmes email-it apo telefonit, sa është i kënaqur me blerjen e realizuar dhe njëkohësisht t'i tregohet për produkte të tjera të cilat do t'i përshtateshin dhe jo që të mos dëgjohen kurrë më me ta.

Këto elemente dhe shumë të tjera të papërmendura i konsideroj shumë me rëndësi për klientin, në veçanti për biznesin, të cilat do t'i ndihmonin në qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë e tij.

# KRU 'Prishtina' kërkon nga qytetarët ta përdorin sa më racionalisht ujin e pijshëm



PRISHTINË, 5 SHKURT (ER) - Kompania Rajonale e Ujësjellësit 'Prishtina' u ka bërë thirrje qytetarët që të shpenzojnë sa më pak ujin e pijshëm. Kjo kompani ka njoftuar se të shpenzuarit racional të ujit të pijshëm është e vetmja mënyrë e krijimit të kushteve elementare për të ardhmen e fëmijëve tanë. "Uji duhet shpenzuar racionalisht jo vetëm gjatë ditëve të nxehta në hapësirë, por ai duhet kursyer edhe gjatë stinëve të ftohta, duke kontrolluar shpenzimin e ujit në objekte të mbyllura, në shtëpi, banesa, institucione apo biznese. Ne e hapim çdo ditë rubinetin në banimet tona për të pirë ujë, për të zier gjëra ushqimore, për t'i larë duart e pastruar fytyrën për nevoja higjienike. E dimë se s'ka gjë më të lehtë e më të shpejtë sesa hapja dhe mbyllja e një rubineti në shtëpitë tona. Por a e dini se rruga e trajtimit të ujit të pijshëm është e gjatë, e mundimshme dhe ka një kosto të lartë derisa të vijë në krojet tona të banimit. Energji elektrike, pompa, pajisje, kimikate, gypa primarë, sekondarë e terciarë, derivate, fuqi punëtore, dije dhe investime, pra është një proces i gjatë që kushton", është thënë në njoftimin e KRU 'Prishtinës'. Sipas kësaj kompanie, menaxhimi i sistemit të ujësjellësit të Prishtinës për të pasur ujë të mjaftueshëm dhe të pastër kushton. "A e dini se 1 000 litra ujë i trajtuar kushton vetëm 0.43 euro, derisa nëse ne e blejmë në dyqane një shishe të ambalazhuar prej 1.5 litrash kushton po aq sa 1 000 litra ujë të ujësjellësit, që ne e sjellim në krojet tuaja, por edhe i monitoruar vazhdimisht me analiza fiziko-kimike dhe bakteriologjike nga laboratori i akredituar i kompanisë sonë dhe njëkohësisht i monitoruar edhe nga Instituti i Shëndetit Publik të Kosovës", është theksuar në njoftimin e KRU 'Prishtina'.

## Kompanitë nga Kosova promovojnë produktet në Panairin Ndërkombëtar "Fruit Logistica" në Berlin

PRISHTINË, 5 SHKURT (ER) - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) ka organizuar pjesëmarrjen e gjashtë kompanive kosovare në Panairin Ndërkombëtar "Fruit Logistica" që po mbahet në Berlin.

Kompanitë prodhuese nga Kosova, Besiana G, Agmia Fruits, Hit-Flores, Santefruit, Iron Consulting dhe Boost Berries po promovojnë produktet e tyre nga pemët dhe perimet. "Ky panair është mundësi e mirë që kompanitë kosovare t'i promovojnë produktet e tyre si dhe të krijojnë bashkëpunim me kompanitë pjesëmarrëse dhe blerës potencialë. Vizitorë të shumtë po shprehin interesim për produktet e Kosovës", thuhet në njoftim.

Panairi Ndërkombëtar "Fruit Logistica" njihet si panairi më i rëndësishëm i industrisë së pemëve dhe perimeve, në të cilit po marrin pjesë mbi 3 300 ekspozues nga 93 shtete pjesëmarrëse, i cili vizitohet nga tregtarë të 135 vendeve nga mbarë bota.



# Guvernatori Mehmeti me përfaqësuesit e Bankës Botërore diskuton për sektorin bankar

Prishtinë, 5 shkurt (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka takuar të mërkurën Diego Martinez, zëvendësdrejtor i Bankës Botërore dhe Alper Ahmet Oguz, zyrtar i lartë për Sektorin Financiar, përgjegjës për portofolin e Kosovës. Me këtë rast, guvernatori Mehmeti ka uruar Alper Ahmet Orguz për detyrën e re dhe i ka siguruar gatishmërinë e Bankës Qendrore për avancimin e projekteve zhvillimore. "Në këtë takim u diskutuan zhvillimet pozitive të sektorit bankar, sfidat e ardhshme dhe roli i këtij sektori në zhvillimin ekonomik të Kosovës, si dhe projektet aktuale dhe të ardhshme të Bankës Botërore për ta mbështetur sektorin financiar", thuhet në njoftimin e BQK-së.
Guvernatori Mehmeti ka informuar zyrtarët e Bankës Botërore lidhur me stabilitetin e sistemit financiar në vend dhe ka falënderuar Bankën Botërore për përkrahjen e vazhdueshme që ka dhënë për zhvillimin e sektorit financiar dhe zhvillimin ekonomik në përgjithësi. Po ashtu, guvernatori Mehmeti i njoftoi përfaqësuesit e Bankës Botërore lidhur me përmirësimin e qasjes në financa e cila në masë të madhe është rezultat i ndihmës së Bankës Botërore dhe mbështetjes që ajo i ka dhënë Fondit Kosovar për Garanci Kreditore.
Përfaqësuesit e Bankës Botërore falënderuan guvernatorin Mehmeti për bashkëpunimin dhe shprehën gatishmëri që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe në të ardhmen.



# BQK-ja kufizon shpenzimet e siguruesve



Prishtinë, 5 shkurt (ER) - Me qëllim të ruajtjes dhe forcimit të stabilitetit të sektorit të sigurimeve, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka miratuar Rregulloren për Menaxhimin e Komisioneve dhe Shpenzimeve Operative të Siguruesve.
Kjo rregullore përcakton kriteret dhe kufizimet për menaxhimin e komisioneve dhe shpenzimeve për siguruesit jojetë si dhe përcakton nivelet e lejuara të komisioneve të ndërmjetësimit dhe shpenzimet operative. "Zbatimi i kësaj rregulloreje do të mbikëqyret nga BQK-ja në mënyrë të plotë përmes raportimit nga ana e siguruesve dhe mbikëqyrjes në vend. Kufizimi i shpenzimeve për komisionet e ndërmjetësimit dhe shpenzimeve operative do të kontribuojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e performancës financiare të këtij sektori dhe, rrjedhimisht, në rritjen e kapaciteteve të siguruesve për t'i paguar dëmet ndaj palëve të dëmtuara", është theksuar në njoftimin e BQK-së.
Sipas këtij njoftimi, miratimi i kësaj rregulloreje është në vazhdën e aktiviteteve të tjera të ndërmarra së fundmi nga BQK-ja për forcimin e qëndrueshmërisë së sektorit të sigurimeve. BQK-ja ka njoftuar se mbetet e përkushtuar për marrjen e të gjitha masave dhe veprimeve të nevojshme për t'i përmbushur detyrat ligjore, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të sistemit financiar dhe mbrojtjes së interesave të publikut.

## Mbi 550 punëtorë të KEDS-it po sanojnë prishjet në rrjet

Prishtinë, 5 shkurt (ER) - Në kushte të vështira atmosferike, gjatë gjithë kohës mbi 550 punëtorë të KEDS-it janë vazhdimisht në terren që nga dita e martë. "Ata po e sfidojnë të ftohtin, borën dhe erërat e forta me misionin e vetëm që ta sjellin energjinë elektrike për konsumatorët anekënd Kosovës. Nga terrenet fushore, deri në bjeshkë, ata gjatë gjithë kohës janë në terren duke ndërruar shtylla, përçues dhe pajisje të tjera përcjellëse të rrjetit, të dëmtuara nga erërat që po shkojnë deri në 100 kilometra në orë. Rrjeti po goditet edhe nga faktorë të tjerë si nga copëza të kulmeve, drunj të thyer e gjësende të tjera që kanë vështirësuar funksionimin dhe punën e tyre. Por, kjo nuk po i ndal. Falë punës së palodhshme të tyre numri i prishjeve është përgjysmuar. KEDS-i për t'ua lehtësuar punën punëtorëve ka huazuar të gjithë kamionët me vinça të mundshëm. Të njëjtën kohë edhe komuna e Istogut dhe e Klinës na kanë ndihmuar me pajisje shtesë që prishjet të evitohen në kohën më të shkurtër të mundshme", ka njoftuar KEDS-i.



## Latifi kërkon nga shërbyesit civilë ta respektojnë orarin e punës

RAHOVEC, 5 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, bashkë me drejtoreshën për Administratë të Përgjithshme dhe drejtorin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, kanë mbajtur takimin e parë periodik me shërbyesit civilë për vitin 2020.
Latifi ka bërë me dije se ka kërkuar nga shërbyesit civilë të kësaj komune që ta respektojnë orarin e punës. "Edhe sot kërkova që të respektohet orari i punës si kusht parësor për një administratë publike të qëndrueshme, të ketë rregullt dhe zbatim të plotë të ligjit dhe etikës së punës dhe ekonomizim të shpenzimeve për një komunë edhe më funksionale dhe shërbime sa më cilësore. U kërkua që shërbyesve civilë t'u kompensohen shpenzimet e udhëtimit dhe shujtës ditore, kërkesë kjo që do të shqyrtohet bazuar në udhëzimet administrative dhe ligjet në fuqi. Si kryetar i komunës kërkoj vazhdimisht rregull dhe respektim të ligjit në vendin ku punohet që së bashku ta japim një pasqyrim të qytetëruar dhe të jemi fryt i një suksesi të përbashkët", ka thënë Latifi.



# AQH-ja zvicerane do të vazhdojë ta mbështesë shëndetësinë e Mitrovicës

MITROVICË, 5 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, i shoqëruar nga drejtoresha e Shëndetësisë, Erseka Hasanaj-Barani dhe drejtori i QKMF-së "Dr. Nexhat Çuni", Fevzi Sylejmani, kanë pritur në një takim përfaqësuesit e organizatës zvicerane Accesible Quality Healthcare (AQH), në krye me udhëheqësin Nicu Fota.
Në këtë takim udhëheqësi i AQH-së, Nicu Fota, ka potencuar se kjo organizatë do të vazhdojë të mbështesë edhe për katër vjet të ardhshëm shëndetësinë në Mitrovicë, në kuadër të projektit për mbështetje në sektorin e shëndetësisë në disa nga komunat e Kosovës. "Do të vazhdohet edhe me fazën e dytë të këtij projekti, sepse faza e parë e projektit ka shkuar shumë mirë dhe bashkëpunimi ka qenë i shkëlqyeshëm me komunën dhe QKMF-në. Ky projekt është i orientuar në tri pika, duke filluar me ofrimin e shërbimeve më të mira shëndetësore, pastaj fuqizimin dhe vetëdijesimin e qytetarëve për të drejtat në marrjen e shërbimeve shëndetësore dhe mbështetjen e ngritjes profesionale", ka thënë Fota.



Ndërsa kryetari i Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka falënderuar dhe vlerësuar lart kontributin e AQH-së për realizimin me sukses të projektit gjatë katër vjetëve të kaluar si dhe për vazhdimin e projektit duke përkrahur sektorin e shëndetësisë për ofrimin e shërbimeve sa më cilësore.
Edhe drejtoresha për Shëndetësi, Erseka Hasanaj-Barani, ka theksuar se AQH-ja është partnere shumë bashkëpunuese dhe falë ndihmës së saj për realizimin e projekteve për sektorin e shëndetësisë kanë arritur të krijojnë kushte më të mira për qytetarët mitrovicas. Në fund, udhëheqësi i AQH-së, Nicu Fota, në shenjë falënderimi për bashkëpunimin e treguar në raport me ofrimin e shërbimeve më të mira shëndetësore për qytetarët e Mitrovicës, ia ka dhuruar një mirënjohje simbolike kryetarit Bahtiri.

# IADK-ja organizon sesion informues për fermerët e Kaçanikut

KAÇANIK, 5 SHKURT (ER) - Organizata joqeveritare Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK) është duke zbatuar projektin "Mbështetja e zinxhirit të vlerave të BMA përmes krijimit të punësimit dhe vazhdimit të eksportit", përkrahur nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, mandatuar nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë. Në kuadër të këtij projekti IADK-ja më 7 shkurt do të organizojë një sesion informues për fermerët e Kaçanikut.
Kjo komunë ka bërë me dije se objektivi i përgjithshëm i projektit është përmirësimi i qëndrueshmërisë së zinxhirit të vlerës për sektorin e bimëve mjekësore aromatike (BMA), përmirësimi i konsistencës në furnizimin dhe mbledhjen e BMA si dhe ngritja e kapaciteteve për pikat e grumbullimit të BMA dhe prodhuesit primarë në konvertimin organik. "Projekti do t'i mbështesë fermerët dhe bizneset që janë të interesuara të angazhohen në sektorin e bimëve mjekësore dhe aromatike apo janë të angazhuar sidomos në zonat rurale përmes shpërndarjes së granteve, dhe asistencës profesionale, me qëllim të krijimit të të ardhurave dhe përmirësimin e gjendjes ekonomike. Shpërndarja e granteve do të bëhet me qëllim të ngritjes së kapaciteteve prodhuese me fokus të veçantë në sektorin e bimëve mjekësore dhe aromatike. "Për informata më të hollësishme në lidhje me aktivitetet e projektit ftohen fermerët që të marrin pjesë në sesionet informuese për vitin 2020", ka njoftuar Komuna e Kaçanikut.

## Ismajli e Zeka takohen për projektin "Duaje liqenin tuaj"

GJILAN, 5 SHKURT (ER) - Nënkryetari i Komunës së Gjilanit, Arbër Ismajli, ka pritur në takim pune drejtorin ekzekutiv të Agjencisë për Zhvillim Rajonal Lindje, Agim Zeka, me të cilin ka biseduar lidhur me projektin "Duaje liqenin tuaj", projekt ky që kjo agjenci do ta implementojë në liqenin e Livoqit, në kuadër të "Empower-Engage-Build Ownership" të financuar nga Zyra e BE-së përmes Balkan Green Foundation (BGF), në partneritet me INDEP.
Ismajli ka njoftuar se ky projekt do të jetë në kohëzgjatje prej gjashtë muajsh, ndërsa objektiv i përgjithshëm i tij është ngritja e vetëdijes dhe vullnetarizmit qytetar për ruajtjen e ujërave dhe mjedisit. "Objektivat specifike të projektit janë largimi i mbeturinave nga liqeni i Livoqit dhe krijimi i një ambienti të këndshëm për vizitorë. Ndërsa si aktivitet kryesor do të jetë organizimi i vullnetarëve për pastrimin e liqenit të Livoqit si dhe vendosja e shenjave informuese, duke përfshirë edhe vendosjen e panove informuese për llojet e peshqve që jetojnë në këtë liqe", ka deklaruar Ismajli pas takimit.
Përmes këtij projekti planifikohet pastrimi dhe mirëmbajtja e liqenit të Livoqit prej muajit mars deri në muajin korrik të këtij viti. Përfitues nga ky projekt do të jenë të gjithë qytetarët e komunës së Gjilanit sepse përmes këtij projekti do të krijohet një ambient i pastër dhe një destinacion për aktivitete të ndryshme rekreative dhe sportive.



# Mali i Zi në goditjen e re serbe, Kosova do të jetë shënjestra e radhës

Maqedonia është lënë në këtë fillimvit jashtë provokacioneve ngaqë Serbia është në pritje të rikthimit të VMRO-s në pushtet për t'iu rikthyer orkestrimit të politikave antishqiptare në koordinim me VMRO-n



Milazim KRASNIQI

Viti 2020 në Ballkan ka filluar ashtu si fillon çdo vit në këtë rajon, kur ritmin e ngjarjeve e dikton fashizmi serbomadh. Pra, edhe viti 2020 ka filluar me trazira të dhunshme të serbëve në Mal të Zi, me kërcënime për shpërbërjen e shtetit në BeH dhe me ndërskamca permanente në Kosovë. Si duket Kroacia ka dalë tashmë nga skenari i fashizmit serb, për shkak të fuqizimit të saj si anëtare e NATO-s dhe e BE-së dhe e armatimit me armatime të sofistikuara këto vitet e fundit. Ndërsa, Maqedonia është lënë në këtë fillimvit jashtë provokacioneve, ngase Serbia është në pritje të rikthimit të VMRO-s në pushtet, për t'iu rikthyer orkestrimit të politikave antishqiptare në koordinim me VMRO-n.

Megjithatë, radiusi i destabilizimeve tash për tash është më i ngushtë edhe për një arsye: Serbia ka shpall zgjedhjet lokale e parlamentare për 26 prill 2020, prandaj në pritje të një mandati të ri, Vuçiqi duhet të tregohet më i përmbajtur.

Koncentrimi i goditjes serbe mbi Malin e Zi, i ka disa përparësi për Vuçiqin. Me këto trazira të orkestruara e të kontrolluara, ai arrin të mobilizojë rreth vetes edhe një pjesë të elektoratit ekstrem në Serbi. Pra, Vuçiqi llogaritë që trazirat në Malin e Zi e ndihmojnë që të fitojë zgjedhjet e 26 prillit 2020. Mund të jetë rastësi që trazirat e reja të inskenuara nga Beogradi në Mal të Zi, përkatësisht "ndodhja e popullit", sërish po ndodhin në janar, si në vitin 1989, me ç'rast nën presionin e protestave, u rrëzua e tërë udhëheqja e atëhershme politike e shtetërore Malit të Zi dhe republika malazeze kaloi nën kontrollin e plotë të Milloshevigit. (Kontrolli serb mbi Malin e Zi pati zgjatur disa vjet, deri sa njëri nga eksponentët e asaj politike, Gjukanoviqi, u rebelua dhe adoptoi projektin e pavarësimit të Malit të Zi. Tash Gjukanoviqi personalisht është nën goditjen e "ndodhjes së popullit" dhe duket se kjo do të jete beteja finale e tij me fashizmin serbomadh).

Por, beteja e fundit e Gjukanoviqit me fashizmin serb, jashtë kontekstit elektoral dhe atij historik, nuk është një betejë dosido. Në këtë betejë janë të implikuar edhe akterë të tjerë, të fshehtë e të hapur. Sikundër dihet, Rusia pati organizuar një tentim atentati ndaj Gjukanoviqit dhe një tentim grushteti në Malin e Zi, për ta penguar anëtarësimin e këtij shteti në NATO. Dështimi i atentatit dhe i grushtetit mundësoi anëtarësimin e Malit të Zi në NATO. Por një deklaratë dhe një gjest i presidentit amerikan, Donald Trampit, ka lënë një shije të hidhur dhe një ndjenjë dyshimi se a e ka fituar Mali i Zi statusin e shtetit-anëtarë, që ka mbrojtjen kolektive të NATO-s. Trampi pati ironizuar pikërisht me Malin e Zi, sikundër që në një takim e pati poshtëruar në mënyrë shumë të pahijshme kryeministrin e Malit të Zi. Mbase për shkak të atyre sinjaleve konfuze, Serbia dhe Rusia janë trimëruar dhe e kanë filluar goditjen e re ndaj Malit të Zi, duke llogaritur që nuk e ka mbrojtjen e plotë të NATO-s? Kjo mbetet të shihet nga deklaratat e udhëheqjes së NATO-s dhe të SHBA-ve, nëse gjerat përkeqësohen më shumë në ditët dhe javët e muajt që vijnë. NATO e SHBA nuk do të duhej të linin që gjërat të përkeqësoheshin, sepse në atë rast virulenca e agresioneve serbe do të shtohej, në drejtim të Bosnjës dhe në drejtim të Kosovës, dy shtete që mbijetojnë vetëm falë aranzhmaneve (Dejtonit dhe Rambujesë) ku garant është SHBA. Sidoqoftë, e pritshme është që goditja e radhës e Serbisë do të jetë ndaj Kosovës, në fillim të vitit 2021, kur ta konsolidojë Vuçiqi plotësisht regjimin e vet. Me të njëjtat pretekste dhe me skenar të ngjashëm, si ky që po shihet në Malin e Zi, por me vendosmëri shumë më të madhe, në mënyrë që copëtimin e Kosovës ta bëjë fakt të kryer. Me këtë rast duhet të kihet para sysh një gjë esenciale: skenar i tashëm i destabilizimit të Mal të Zi i ka tre elementet themelore që përdorte Milloshevigi për rrëzimin e udhëheqjes në Mal të Zi, në Kosovë e në Vojvodinë në vitet 1989-1990. E para, përdorimi i konflikteve ndëretnike, të cilat fillimisht i nxitë vetë Serbia, mandej shfaqet si mbrojtës i serbëve. Këtë skemë është duke e përdorë saktësisht në Mal të Zi edhe tash. Qeveria e Beogradit ika nxitë Kishën Ortodokse Serbe dhe partitë opozitare që deklarohen si serbe, që të kundërshtojnë ligjin për liritë fetare. Fillimisht u tentua pengimi me dhunë i miratimit të ligjit në Kuvendin e Malit të Zi, pastaj u shfaqën priftërinjtë serbë në krye me mikun e Koshtunicës, Amfillohijen dhe i zgjeruan protestat nëpër shumicën e qyteteve të Malit të Zi. Protestat e tilla ditore, nganjëherë edhe të dhunshme, po shkaktojnë ftohjen e marrëdhënieve ndërnacionale në Malin e Zi, ndërsa ftohja pastaj përdoret nga propaganda dhe nga regjimi serb si pretekst "për t'i ardhur në ndihmë popullit të rrezikuar serb". Elementi i dytë që po përdorë Serbia në Malin e Zi edhe në vitin 2020 e që e ka përdorë edhe në vitin 1989 është pretendimi i nënkuptuar territorial ndaj veriut të Malit të Zi. Dhe e treta, propaganda serbe tërë kohën propagandon kundër Gjukanoviqit dhe qeverisë së tij si qeveri e korruptuar, me synim që ta denigrojë e të dobësojë në sytë e qytetarëve malazez po edhe të faktorëve ndërkombëtar.

Trazirat dhe ndërhyrjet në Malin e Zi janë duke vazhduar, ashtu që epilogu i tyre nuk dihet. Ndoshta ato mund të mbahen deri sa të kryhen zgjedhjet në Serbi. Por ajo që dihet është se Serbia ka mbetur e vendosur në mbajtjen pezull të projektit të saj të krijimit të Serbisë së Madhe, duke atakuar Malin e Zi, Kosovën dhe Bosnjën. E pritshme është që Kosova do të jetë shënjestra e radhës. Për këtë arsye, duhet të llogaritet që trazirat e tashme në Malin e Zi taktikisht kanë të bëjë edhe me Kosovën. Pas zgjedhjes së një qeverie të re, Vuçiqi do të gjejë momentumin që të godasë fort mbi Kosovën, me trazira të serbëve, me pretendime territorial përkatësisht me projektin e copëtimit të Kosovës dhe me propagandë kundër institucioneve të Kosovës. Për këtë arsye Kosova duhet të solidarizohet sot me Malin e Zi. Dhe përtej kësaj, duhet të përgatitet që të kundërvihet ndaj skenarit destabilizues e gllabërues të radhës, që e pret më së largu në fillim të vitit 2021, ndoshta edhe më herët.

# Hoti u dhuron libra të miturve dhe grave në Qendrën Korrektuese në Lipjan

Lipjan, 5 shkurt (ER) - Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në Qeverinë e Republikës së Kosovës, Rexhep Hoti, të mërkurën ka dhuruar 530 libra në Qendrën Korrektuese në Lipjan.

Koordinatori Hoti dhuroi fillimisht librat në qendrën për të mitur. Aty ai foli për rëndësinë e shkollimit dhe arsimimit si një mundësi e vetme për t'i arritur qëllimet dhe sukseset jetësore. "Ne të gjithë bëjmë gabime, dikush më pak e dikush më shumë. Nëse ju jeni këtu, do të thotë se ne si persona përgjegjës, qoftë si qeveri, qoftë si prindër, jemi të këqij sepse nuk jemi kujdesur sa duhet për juve. Por, mos harroni, përmes leximit mund ta arrini formimin e personalitetit. Ju këshilloj të provoni të lexoni sepse koha do të shkojë më shpejt dhe ju do të pasuroheni me dije. Sot ju kemi sjellë libra sepse arsimi është dritë dhe diell për çdo njeri dhe leximi është shpëtim nga çdo problem e çdo dukuri negative", ka thënë koordinatori Hoti.

Në anën tjetër, drejtori i pavijonit për të mitur, Arif Beqa, e falënderoi koordinatorin Hoti për donacionin si dhe kërkoi nga ai që të mundësojë për ta miturit shkollimin në shkollat publike ashtu siç parashihet me ligj dhe udhëzime administrative. "Ne mund të bashkëpunojmë edhe në aspektin e mbajtjes së garave për të miturit në qendrën tonë



sepse do të ndodhte një aktivitet i jashtëzakonshëm për ta", ka thënë Beqa.

Koordinatori Hoti u prit edhe nga stafi drejtues i pavijonit të grave ku, po ashtu, dhuroi libra. Ndërkaq banorët e Qendrës Korrektuese u ndanë shumë të kënaqur me librat që ju dhuruan. "Nuk kemi pasur në bibliotekën tonë libra kaq të mirë nga autorë të njohur andaj shumë faleminderit për këtë donacion!", ka deklaruar një nga banoret.

# Trumpi përshëndet 'kthimin amerikan' në fjalimin drejtuar kombit

Presidenti amerikan Donald Trump gjatë fjalimit të tretë drejtuar kombit ka thënë se do të qëndrojë mbrapa përfitimeve shoqërore dhe të atyre për kujdes shëndetësor, nëse fiton një tjetër mandat katërvjeçar dhe se ka arritur atë që ai e ka cilësuar si "kthim të kombit" nën udhëheqjen e tij


MICHAEL REYNOLDS (EPA-EFE)

UASHINGTON, 5 SHKURT - Presidenti amerikan, Donald Trump, ka shtyrë përpara arritjet ekonomike të Shteteve të Bashkuara nën udhëheqjen e tij, gjatë fjalimit të tretë drejtuar kombit, teksa ka thënë se do të qëndrojë mbrapa përfitimeve shoqërore dhe të atyre për kujdes shëndetësor, nëse fiton një tjetër mandat katërvjeçar.

Trump, i cili ka fituar zgjedhjet presidenciale të vitit 2016 me sloganin "Bëni Amerikën të mrekullueshme sërish", ka deklaruar në Kongres se ka arritur atë, që ai e cilësuar si "kthim të kombit" nën udhëheqjen e tij. "Vendet e punës janë shtuar, të hyrat janë rritur, varfëria ka rënë, krimi ka rënë, vetëbesimi është rritur dhe shteti ynë është jashtëzakonisht i respektuar sërish", ka thënë ai, para se të prezantonte statistikat për paga, vende të punës dhe tregje të aksioneve, ka njoftuar rfe.

Trumpi ka thënë se ka realizuar premtimin e tij gjatë fushatës për të zëvendësuar Marrëveshjen e Amerikës Veriore për Tregti të Lirë, duke pretenduar se ai pakt ka ndikuar në mbylljen e vendeve të punës, andaj Trumpi ka nënshkruar një marrëveshje të re me Kanadanë dhe Meksikën, një javë më parë. "Marrëveshja e parë e madhe tregtare në shumë vjet", ka thënë Trumpi duke pretenduar se ajo do të ndikojë në hapjen e 100,000 vendeve të reja të punës.

Trumpi ka diskutuar për ekonominë në 20 minutat e parë të fjalimit të tij para se të niste diskutimin për kujdes shëndetësor dhe imigrim ilegal, dy çështjet e tjera kyçe të fjalimit të tij.

Fjalimi i presidentit amerikan këtë vit ka ndodhur në kohën e zhvillimit të gjyqit kundër Trumpit, i cili ka ndarë si Kongresin ashtu edhe kombin. Dhoma e Përfaqësuesve, e drejtuar nga demokratët, ka miratuar dy akuzat kundër Trumpit në dhjetor të vitit të kaluar. Mirëpo Senati i kontrolluar nga republikanët, pritet ta shfajësojë atë më 5 shkurt.

Trumpi akuzohet për abuzim të pushtetit dhe pengim të punës së Kongresit, pasi dyshohet se ka kushtëzuar ndihmën ushtarake për Ukrainën, në këmbim të hetimeve për rivalin e tij politik, Joe Biden. Prandaj, tensioni mes dy partive, është ndjerë edhe më shumë gjatë fjalimit të Trumpit. Teksa i ka dhënë një kopje të fjalimit kryesuesja e Dhomës së Përfaqësuesve, Nancy Pelosi, e cila ka qenë e ulur mbrapa presidentit, është parë duke i zgjatur dorën Trumpit, mirëpo ai e ka injoruar atë.

Pas fjalimit, Pelosi është parë duke shqyer fjalimin e presidentit.

Pelosi ka qenë në krye të nisjes së procedurave për gjyqin kundër Trumpit, andaj është raportuar se të dy zyrtarët nuk kanë biseduar nga muaji tetor.

Gjatë fjalimit të tij, Trumpi nuk ka komentuar gjyqin kundër tij. Demokratët kanë qenë dyshues ndaj shifrave që kanë përmendur Trump, derisa republikanët janë dëgjuar duke brohoritur "katër vjet të tjera".

Trumpi synon të rizgjidhet këtë vit si president i SHBA-së, prandaj në fjalimet e tij që po zhvillon në shtetet amerikane, ai është fokusuar në rritjen ekonomike dhe luftimin e imigrimit ilegal.

Ndërkohë më 3 shkurt në Ajova është mbajtur rrethi i parë i zgjedhjeve, për të kuptuar se kush nga demokratët mund ta fitojë nominimin për të garuar për president.

Në një sondazh të publikuar nga Gallup para fjalimit të Trumpit, është parë se shkalla e përkrahjes ndaj tij është 49 për qind, çka prezanton shifrën më të lartë prej kur ai ka ardhur në pushtet më 2017. Megjithatë, vetëm 7 për qind e demokratëve miratojnë performancën e tij për dallim nga 94 për qind e republikanëve. Kjo e dhënë prezanton dallimin më të thellë të regjistruar ndonjëherë nga Gallup mes përkrahësve të partive politike në SHBA.

Trumpi ka përmendur sërish fushatën kundër imigrimit, që i ka ndihmuar të fitojë zgjedhjet e vitit 2016. Ai ka thënë se administrata e tij ka përparuar në arrestimin e imigrantëve pa dokumente, ose ka parandaluar hyrjen e tyre në SHBA.

Presidenti ka thënë se muri që po ndërtohet në kufirin e SHBA-së me Meksikën do shkojë në 800 kilometra deri në fillim të vitit të ardhshëm. Ai ka kritikuar politikanët që kanë parandaluar Zyrën për Imigrim dhe Dogana për t'i dëbuar imigrantët pa dokumente.

Përveç të tjerash, Trumpi ka kritikuar edhe një projektligj të demokratëve që ofrojnë kujdes shëndetësor për imigrantët pa leje, duke thënë se një gjë e tillë është "joshje e madhe për imigrantët ilegalë", të cilët do të përfitonin nga amerikanët e vjetër.

Trump po ashtu ka shpenzuar kohën më të madhe të fjalimit duke folur për sistemin shëndetësor të shtetit, duke përfshirë uljen e çmimit të ilaçeve.

Përveç marrëveshjeve tregtare, presidenti ka përmendur pak edhe politikën e jashtme.

Ai ka thënë se ka gatishmëri për t'iu dhënë fund sanksioneve kundër Iranit, nëse ky shtet braktis armët bërthamore dhe ndalon financimin e terrorizmit. "Ne mund t'iu ndihmojmë atyre të rrisin ekonominë në kohë shumë të shkurtër, mirëpo ata ose janë shumë krenarë, ose shumë budallenj për të kërkuar ndihmë. Ne jemi këtu. Do të shohim cilën rrugë do ta zgjedhin ata", ka deklaruar Trumpi.

Ai, po ashtu, ka thënë se është duke punuar në marrëveshjen për t'i dhënë fund luftës 18-vjeçare në Afganistan, ashtu që të kthejë në shtëpi forcat amerikane. Sipas traditës, në fjalimin drejtuar kombit, një anëtar i kabinetit të presidentit nuk duhet të jetë në sallë.

Ai ose ajo duhet të qëndrojë në një vend sekret për t'u siguruar se qeveria do të vazhdojë punën, në rast se ndodh ndonjë fatkeqësi në sallën ku gjendet presidenti, nën-presidenti dhe liderë tjerë shtetërorë.

Personi që këtë herë është shpallur i mbijetuar, ka qenë Sekretari i Brendshëm, David Bernhardt.



Reuters

# Aeroplani del nga pista në Stamboll, dhjetëra të plagosur

ANKARA, 5 SHKURT - Një aeroplan pasagjerësh doli nga pista në një aeroport të Turqisë, duke u ndarë në tri pjesë. Autoritetet thanë se 52 njerëz janë plagosur.

Askush nuk ka vdekur në incident, tha ministri i Transportit i Turqisë, Mehmet Cahit Turhan.

Incidenti ndodhi në Aeroportin Sabiha Gokcen të Stambollit.

Aeroplani i përkiste kompanisë Pegasus Airlines, ndërsa në bord gjendeshin 171 pasagjerë dhe gjashtë anëtarë të ekuipazhit. Sipas mediave lokale, aeroplani ateroi në shi të madh, pasi fluturoi nga provinca perëndimore e Izmirit.

# Një natë në Lisbonë – Erih Maria Remark (24 orë nga jeta e Jozef Shvarcit)

Nga Xheni SHEHAJ



Remarku është ndër shkrimtarët më të rëndësishëm të shekullit të XX-të. Autor i disa romaneve të suksesshme, ai ka sjellë tek lexuesit dramën e një kombi të tërë. Duke qenë edhe vetë pjesëmarrës në luftë, duke qenë dëshmitar i tmerreve, torturave, krimeve, Remarku ka mundur të përshkruajë përsosmërisht ndjenjat më të natyrshme njerëzore të tilla si: dashuria, dhembshuria, frika, uria, nostalgjia. Personazhet e Remarkut janë realë, të ndjeshëm, humanë. Letërsia e tij është e mbushur me humanizëm, në të gëlon jeta, por edhe vdekja. Realizmi dhe romantizmi i autorit ecin paralelisht.Ndoshta kjo është dhe arsyeja që emri dhe veprat e tij nuk janë lënë në harresë por vazhdojnë të lëvrohen fort edhe në kohën që jetojmë. Remarku është eksplorator ndjenjash. Ai ka ditur të përdorë simbole, të heqë paralele, të përdorë muzikën për të treguar gjendje të caktuar rrëfimi, të shfrytëzojë natyrën, ujin e plot elemente që i japin veprave të tij bukuri dhe stil unik.

## Subjekti i romanit shkurtimisht

Viti 1942. Një burrë endet natën nëpër portin e Lisbonës duke vështruar anijen që të nesërmen do të niset për në Amerikë. Synimi i tij është të shkojë në "dheun e premtuar" por ai nuk ka as vizë, as para. Jozef Shvarc, një i panjohur, i dhuron burrit që endet në port dy bileta udhëtimi por me një kusht: që burri mos ta lërë vetëm atë natë dhe të dëgjojë historinë e tij. Kështu nis rrëfimi i Shvarcit për jetën e tij, arratisjen nga Gjermania pasi i kunati e spiunoi, ritakimin me të shoqen, Helenën, arratisjen e të dyve. Shvarci i tregon të panjohurin për ndodhitë që ka kaluar bashkë me të shoqen nga një shtet në një tjetër, i tregon për sëmundjen e saj, për kampin ku ajo ndenji për ca kohë dhe për burgun ku qëndroi ai, për kunatin nazist që nuk ju ndahej e i ndiqte këmba – këmbës derisa Shvarci e vrau. Në fund bashkë me të panjohurin e përcolli trupin e Helenës për në banesën e fundit dhe pasi u nda me "dëgjuesin" e historisë së tij, u regjistrua në Legjionin e huaj.

## – Rrëfimi

Romani "Një natë në Lisbonë" qëndron mbi dy rrafshe rrëfimesh. Rrëfimin e nis një burrë i ri, një gjerman pa identitet, i cili kërkon të largohet nga porti i Lisbonës drejt Amerikës. Ky burrë ka mundur t'i shpëtojë kthetrave të nazizmit dhe tashmë po bën përçapjen e fundit për të fituar lirinë. Por si emigrant që është nuk ka as vizë, as biletë për anijen që do të lundrojë drejt "tokës së ëndrrave" dhe as para. I kredhur në dëshpërim, burri ecejaket nëpër mol. Jozef Shvarci, një gjerman me identitet të rremë, ndodhet në të njëjtin port me burrin e panjohur. Të dy patriotët takohen vetëm sepse Shvarci kërkon medoemos të hyjë në bisedë me të panjohurin. Dhe pikërisht në këtë çast shtylla e rrëfimit parësor thyhet për të kaluar fillimisht në një bashkëbisedim e më pas në një tjetër rrëfim, atë të vetë Shvarcit. Romani mbyllet me rrëfimin e burrit të panjohur, i cili pasi është ndarë me Shvarcin vazhdon të rrëfejë fundin e odisesë së tij.

Jozef Shvarci i rrëfen të panjohurit historinë e jetës së tij që nga arratisja prej kampit të përqëndrimit (brenda të cilit e pati futur i kunati), vendosja në Francë, kthimi sërish në atdhe fshehurazi për të takuar gruan, arratisja e të dyve, peripecitë nëpër vende të ndryshme e deri në momentin kur takoi atë, dëgjuesin e tij. Një odise e vërtetë. Shvarci në fillim i dhuron të panjohurit dy bileta për në Amerikë, me kushtin e vetëm që ai ta kalojë natën me të e të dëgjojë gjithë historinë e tij. Përmes rrëfimit që Jozef Shvarc bën përballë të panjohurit kërkon t'i lërë lamtumirën vetes së tij, identitetit të tij të rremë, të huazuar nga një çifut austriak, jetës së jetuar deri më atëherë. Shvarci tenton të "zhbëjë" vetveten që ka gjalluar gjatë atyre viteve, të hedhë pas gjithë sa ka jetuar e të rinisë një jetë tjetër, si dikush tjetër. Dy burrat e kalojnë natën sa në një bar, në një tjetër, duke pirë. Njëri rrëfen, tjetri dëgjon, e hera – herës, ndërthuret një bisedim i shkurtër mes tyre.

## – Simbolet

Remarku në romanin në fjalë ka përdorur një sërë simbolesh.

– *Episodi i ndriçimit*; është ndër të parët që përmendet. Në Lisbonë llamburisin dritat, ndërsa në Gjermani të mbyst errësira. Ky paralelizëm bart në vetvete një simbolikë të fortë, atë të errësirës naziste.

"Po bëhej një javë që isha në Lisbonë dhe prapë nuk po mësohesha me ndriçimin e shkujdesur të këtij qyteti. Në vendet nga vija unë, qytetet natën dukeshin si miniera qymyri, dhe një fener në atë errësirë ishte më i rrezikshëm se kolera në mesjetë. Këtu njeriut i duket sikur dikush ka harruar të mbyllë dritën, dhe i bëhet sikur nga një çast në tjetrin do shpërthejë ndonjë sulm ajror."

– *kështjella;* Shvarci dhe Helena gjatë arratisjes së tyre nëpër Francë mbërrijnë të strehohen përkohësisht në një vilë të braktisur që ngjan si kështjellë. Ai vendqëndrim simbolizon strehën, sigurinë, mbrojtjen.

– *kishat dhe muzetë;* në libër përmendet disa herë se kishat dhe muzetë ishin vende të sigurta për të mos rënë në sy gjatë regjimit nazist. Kjo lidhet me faktin që nazistët nuk kishin kohë të merreshin me Zotin dhe me artin.

– *uji;* është përdorur gjerësisht në vepër dhe thuajse më së shumti ka të njëjtën domethënie, pastrimin, largimin e pisllëkut (këtu nënkuptohen kujtimet e këqija, përndjekjet, torturat). Kredhja ose zhytja në ujë ndodh si me Shvarcin, i cili zhytet për të kaluar kufirin, ashtu dhe me Helenën, e cila zhytet për të notuar. Të dy përjetojnë një lloj qetësie dhe shplodhjeje, pasi uji i qetë dhe i njëtrajtshëm ua ka platitur shpirtin për pak kohë.

"Isha shumë i qetë dhe plotësisht i çlodhur. Më dukej sikur merrja frymë sipas ritmit të ujit. Uji rridhte si frymëmarrja ime, dhe bashkë me të, përshkohej nëpër trupin tim."

– *natyra;* shfaqet në të gjitha dimensionet e saj në vepër. Herë e buzëqeshur e me diell, e herë me shi e trishtim. Personazhet duken sikur lëvizin pambarimisht në natyrën që ndryshon veshje. Shpesh herë ajo i ka strehuar të arratisurit në gjirin e saj të madh, e herë të tjera i ka marrë në mbrojtje duke u falur disa orë gjumë.

"Gjatë tërë kësaj kohe natyra qe për ne diçka jetike, ashtu siç është për kafshët. Ishte e vetmja që s'na dëboi kurrë. Në gjirin e saj nuk kishim nevojë as për pasaportë e as për dëshmi prejardhjeje ariane."

– *muzika;* luan rol të rëndësishëm në roman. Muzika e tavernës ku ulen fillimisht Shvarci dhe dëgjuesi i tij, është këngë sentimentale e dramatike e luajtur në kitarë si për të ecur paralel me rrëfimin që do të nisë Shvarci. Në klubin rus të natës muzika është melankolike dhe përputhet përsosmërisht me tregimin e Jozefit për kthimin në vendlindje, nostalgjinë për shtëpinë e gruan. Ndërsa kur ai nis të rrëfejë historinë e tij të dashurisë me të shoqen, Helenën, ritakimin e tyre pas pesë vitesh mungesë, në barin ku janë ulur orkestra luan një vallëzim.

– *Shvarc*; vetë mbiemri i personazhit në gjuhën gjermane do të thotë "i zi", çka mund të nënkuptojë fatin e keq që ndoqi këmba – këmbës Jozef Shvarcin, vdekjen e së shoqes, arratisjet, etj.

– *kanarina në kafaz dhe macja mbi parvaz;* kanarina këtu simbolizon personazhin e Helenës e cila është ngujuar në kafazin e sëmundjes. Macja nënkupton kancerin, sëmundja që po i merr jetën Helenës.

– *era e vdekjes;* Helena që vuan nga kanceri dhe e pret vdekjen stoikisht, është më e ndjeshme ndaj erës së vdekjes. Por erë vdekjeje shpërndajnë dhe nazistët, dhe çizmet e tyre, uniformat dhe makinat. Kudo ndjehet era e saj.

Të gjitha këto simbole e bëjnë romanin më domethënës e tërheqës. Në vepër nuk mungon mendimi filozofik, urtësia dhe përvoja. Arsyetimet e Shvarcit mbi Zotin dhe vdekjen janë një pasazh i vogël i librit. Në fund të romanit Jozefi në bashkëbisedim me të panjohurin, kërkon të kapë kuptimin e jetës së tij.

"Jua rrëfeva jetën time, sepse dua ta di ç'ka qenë. Mos ka qenë vallë një jetë boshe, e kotë, jeta e një njeriu të padobishëm, e një burri që i vënë brirë, e një vrasësi…"

E pra kjo mori dyshimesh mbi jetën e jetuar vjen ose kur njeriu është në fund të jetës dhe ndjen se po ecën drejt vdekjes, ose kur lufta, jeta e vështirë, e ka tjetërsuar deri në atë masë sa nuk di më se ç'jetë ka jetuar. Dhe është pikërisht kjo e fundit që autori ka shfrytëzuar për të ravijëzuar e sjellë aq bukur personazhin e Shvarcit. Këtë di ta bëjë vetëm Remarku.*/exlibris*



E jashtëzakonshme

# Shkencëtarët: Bota do të hyjë në një epokë akullnajash në 30 vjetët e ardhshëm



Bota mund të përballet me një epokë të re akullnajash në 30 vjetët e ardhshëm dhe stuhi bore të tmerrshme për shkak të minimizimit ciklik të rrezatimit të diellit. Goditjet e të ftohtit që vijnë nga të ashtuquajturat "hibernime" të diellit mund të rrezikojnë ndërkohë planetin me uri. Sipas NASA-s, dielli do ta arrijë aktivitetin më të ulët gjatë këtij viti dhe kjo mund të bëjë që temperaturat mesatare të bien ndjeshëm.

FOTO E DITES



Dy gra shihen duke bartur me karroca ndihma ushqimore në qytetin e Pissilas në Burkina Faso. /Reuters/

E rrallë

# 'Shtëpia në rrota', "Porsche" shet autobusin luksoz për dy milionë dollarë



Gjiganti gjerman "Porsche" ka dizajnuar një autobus luksoz i cili lirisht mund të thuhet se është shtëpi në rrota dhe që është shitur në Oklahoma të ShBA-së te një burrë shumë i pasur. Bëhet fjalë për mjetin Newell Coach p50 që është 14 metra i gjatë, brenda të cilit nuk mungon pothuajse asgjë. Ky autobus është shitur për dy milionë dollarë dhe ka dhomë të madhe gjumi, tualet dhe televizor gjigant të teknologjisë së fundit. Kur flasim për luks, nuk ka se si të mungojë edhe kuzhina dhe ambienti tjetër për mysafirë.

## BARSOLETA E DITËS



Fola me pronarin e një firme.
- Sa është paga në firmën tuaj?
- Në fillim 200 euro, më vonë 500 euro.
- Atëherë vij më vonë.

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**




Në ora 18:00

## Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

**Rolet:** Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

**Regjia:** Troy Quane, Nick Bruno




Në ora 18:00

## Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min

**Rolet:** Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.

**Regjia:** Jake Kasdan




Çdo natë në ora 20:00

## STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min

**Rolet:** Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj

**Regjia:** J.J. Abrams




Çdo natë në ora 22:30

## THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

**Rolet:** Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

**Regjia:** Takashi Shimizu

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Në punë ngërçi ju shqetëson pak, por mos e humbni shpresën: së shpejti do ta bëni atë!



**DEMI**
Ditë e karakterizuar nga humbje të shumta parash. Në fushën dashurore gjithçka është në rregull.



**BINJAKËT**
Me mosmarrëveshjen e Venusit dhe Mërkurit do të ishte e përshtatshme që të përmbaheni ose të pakësoni disa shpenzime të panevojshme.



**GAFORRJA**
Ata që tregojnë mirëqenien e tyre, ndoshta e bëjnë me qëllim që t'ju irritojnë; është vetëm një situatë mashtruese.



**LUANI**
Në horizont po vjen një ditë e këndshme, e cila ju bën të harroni mendimet negative të ditëve të kaluara.



**VIRGJËRESHA**
Në punë ekzaminoni me kujdes objektivat duke eliminuar ato që nuk kanë funksionuar. Kthejini vështirësitë si një trampolinë drejt një të ardhme tjetër.



**PESHORJA**
Do të keni mundësi të shkëlqyera për ta realizuar veten dhe për ta mbyllur ditën me kënaqësi personale dhe ekonomike.



**AKREPI**
Ju mbase përmes ëndrrave që flasin për dashurinë mund të doni të përjetoni një fije erotizmi, por nuk ka për të ndodhur kështu ditën e sotme.



**SHIGJETARI**
Shumë keq për ta filluar ditën me një hënë të pakëndshme përballë shenjës. Përgatituni për një emergjencë që do t'ju detyrojë t'i përvishni mëngët dhe të punoni shumë.



**BRICJAPI**
Së pari duhet të përgatisni një plan veprimi të planifikuar dhe, mbi të gjitha, të besueshëm. Mos u dorëzoni në tundimin e improvizimit.



**UJORI**
Do të ketë disa biseda në shtëpi, por të paktën nuk do të ketë grindje. Dashuria buzëqesh tek ata që sapo e kanë zbuluar ose rizbuluar atë.



**PESHQIT**
Ndoshta ju as nuk e vini re atë, por keni pasur disa shenja të vogla të ngadalësimit dhe për këtë arsye do të ishte e përshtatshme t'i ngadalësoni ritmet tuaja.

# Përgatituni për Justin Bieberin



Justin Bieber po paralajmëron se diçka emocionuese po vjen. Këngëtari 25-vjeçar i hitit "Yummy" zbuloi se ka një njoftim për të na dhënë. Këtë e bëri me dije me anë të një postimi në 'Twitter' ngacmues. "Njoftim i madh. 9 ditë" shtoi ai disa orë më vonë, duke aluduar në albumin e tij të ardhshëm "Changes", i cili do të publikohet në ditën e Shën Valentinit.

# Katy Perry shfaqet me stil të veçantë



Ajo ka punuar për një kohë të gjatë në Hawai për t'i bërë përgatitjet e serisë tjetër të American Idol, shkruan 'Daily Mail'. Por këngëtarja e famshme Katy Perry është parë me një stil tejet të veçantë pasi zbriti në aeroportin Heathro. Superylli ra në sy të turmës pasi kishte veshur një fustan të gjatë me ngjyrë rozë.



# Ashley Graham publikon portretin familjar

Ashley Graham ka pak ditë që është bërë nënë për herë të parë. Modeluesja e njohur dhe bashkëshorti i saj Justin Ervin morën epitetin prindër. Ashley vendosi që ta prezantojë edhe me ndjekësit vogëlushin e sapolindur, duke publikuar një portret të ëmbël familjar. Modeluesja njoftoi se vogëlushin e kanë pagëzuar Isaac, ndërsa shprehet e lumtur që ka pranë atë dhe partnerin.

# Jennifer Lopezi shfaqet pa grim pas 'Super Bowl'




Performanca e tyre tërhoqi vëmendje të madhe në "Super Bowl" të dielën që lamë pas, shkruan 'Daily Mail'. Jennifer Lopez dhe Shakira e kanë bërë hapjen e kësaj shfaqje duke 'elektrizuar' publikun, mirëpo të mërkurën J. Lo është shfaqur pa grim dhe me rroba sportive, bashkë me burrin e saj Alex Rodriguez.




Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

# Dumoshi: Do të bashkëpunojmë në interes të komunitetit të rinisë dhe sportit

Vlora Dumoshi e ka pranuar detyrën e ministres së MKRS-së nga ish-ministri Kujtim Gashi, i cili e ka njoftuar ministren e re për punët dhe sukseset që janë arritur gjatë kohës sa ai e drejtoi këtë ministri dhe projektet që janë në realizim e sipër. Ndërsa Dumoshi ka premtuar se do të bashkëpunojmë në interes të komunitetit të rinisë dhe sportit



**Prishtinë, 5 shkurt (ER)** - Ministri në largim, Kujtim Gashi, ia ka dorëzuar të mërkurën detyrën e udhëheqjes së Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ministres Vlora Dumoshi. Gashi e ka uruar Dumoshin për marrjen e detyrës dhe i ka dëshiruar mbarëvajtje të punës, arritje të objektivave dhe realizim me sukses të projekteve në kuadër të periudhës që ajo do ta udhëheqë MKRS-në. "Për mua është kënaqësi e veçantë ta pres për t'ia dorëzuar postin zonjës Dumoshi. Jam i bindur që sot vjen një figurë shumë e respektuar e Prishtinës që ka dhënë kontribut si drejtoreshë në Prishtinë. Pra, vjen një ministre që e njeh punën", ka thënë Gashi, i cili e ka njoftuar ministren Dumoshi për punët të cilat janë realizuar gjatë kohës sa ai e ka udhëhequr MKRS-në. Ai e ka informuar ministren për sukseset e arritura si dhe për sfidat që është përballur kjo ministri gjatë kësaj periudhe si dhe për projektet që janë në realizim e sipër.
Ndërkaq, ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, u shpreh e kënaqur për punën e deritanishme që është bërë në MKRS, duke theksuar se do të përkushtohet që të punohet në bazë të programit qeverisës me qëllim të avancimit të performancës dhe realizimit të projekteve të rëndësishme në kulturë, sport, trashëgimi kulturore dhe rini. Ajo bëri me dije se do të punojë ngushtë me komunitetin e kulturës dhe sportit dhe me ata që janë të gatshëm të bashkëpunojnë. "E vlerësoj pritjen tuaj. Unë e siguroj komunitetin kulturor dhe sportiv që do të punoj. Puna ime do të jetë e afërt me këto komunitete. Do të bashkëpunojmë në interes të qytetarëve, në veçanti të komunitetit të rinisë dhe sportit", ka thënë Dumoshi.

## SHKURT

### Unitedi në garë për Kumbullën

Marash Kumbulla pritet të jetë një nga lojtarët më të kërkuar në afatin kalimtar të verës. Mbrojtësi shqiptar po shkëlqen me fanellën e Veronës dhe në garë për shërbimet e tij janë dy klubet italiane, Interi dhe Napoli. Mirëpo e ardhmja e futbollistit kuqezi mund të jetë larg Italisë, pasi garës për shërbimet e tij i është shtuar edhe Manchester Unitedi. Përfaqësues të skuadrës angleze e kanë përcjellë nga afër Kumbullën në ndeshjen ndaj Milanit dhe kanë dhënë sinjalin pozitiv që të bëhet ofertë konkrete. Verona nuk do ta shesë yllin e saj për vlerën nën 25 milionë euro.

### Vëllaznimi prezanton dy përforcime

Skuadra e Vëllaznimit ka vazhduar përforcimet para fillimit të stinorit pranveror të garave në Ligën e Parë. Gjakovarët e kanë rikthyer ish-sulmuesin e ekipit, Ermir Nikoliqi, i cili për një kohë ishte joaktiv, derisa në vitin e kaluar djersiti fanellën e KF Gjakovës. Kuqezinjve u është bashkuar edhe talenti Gardison Tunaj, i cili vjen nga KF Dardanët. Vëllaznimi do të luftojë për mbijetesë në Ligën e Parë këtë edicion dhe do ta ketë mjaft të vështirë.

### Guiffredi: Hysaj do të largohet nga Napoli

Elseid Hysaj ka rigjetur formacionin dhe qetësinë te Napoli. Me uljen në bankinë te Genaro Gattuso, kapiteni i kombëtares shqiptare është kthyer sërish në një lojtar titullar, status të cilin e kishte humbur kur skuadra drejtohej nga Carlo Ancelotti. Megjithatë, ky pritet të jetë sezoni i fundit i Hysajt me Napolin dhe për ta konfirmuar këtë mendon menaxheri i tij, Mario Guiffredi. "Në merkato ka disa dinamika që nuk të lejojnë t'i përfundosh të gjitha operacionet. Unë nuk dua që Hysaj të qëndrojë te Napoli. Për këtë arsye, objektiv është që ai të largohet", ka thënë agjenti i futbollistit shqiptar.

## Ish-lojtari i Bursasporit dhe Fenerbahçes, Fatlind Azizi, përforcon Gjilanin

**Gjilan, 5 shkurt** - Skuadra e Gjilanit ka bërë sot një transferim bombastik. Bëhet fjalë për ish-lojtarin e Bursasporit dhe Fenerbahçes, Fatlind Azizi. "SC Gjilani ju njofton për arritjen e marrëveshjes me futbollistin Fatlind Azizi. Klubi ka 'firmosur' me mesfushorin 19-vjeçar duke e parë si të domosdoshëm për objektivat që janë vënë për këtë edicion. Azizi, i cili luan në rolin e mesfushorit të qendrës, vjen me një përvojë nga kampionati turk, me ç'rast për dy vjet ishte pjesë e të rinjve të Bursasporit dhe Fenerbahçes. Përvoja e tij në kampionatin e të rinjve në Turqi pritet të jetë një ndihmesë e madhe për klubin", thuhet në njoftimin e Gjilanit. Skuadra nga Anamorava është një nga favoritet në garën për titull, kurse është kualifikuar edhe në çerekfinale të Kupës ku përballë do ta ketë Drenicën.



## Dënohen duhanpirësit e Përfaqësueses

PRISHTINË, 5 SHKURT - Këshilli për Çështje Emergjente i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) i ka përjashtuar nga Përfaqësuesja e Kosovës në futsall futbollistët Oso Gjinovci, Bajram Ramadani dhe Dardan Topilla. "Futbollistët Oso Gjinovci, Bajram Ramadani dhe Dardan Topilla gjatë udhëtimit për Gjeorgji kanë pasur sjellje që nuk përkojnë me rregullat e etikës së një futbollisti përfaqësues, ndaj Këshilli për Çështje Emergjente ka marrë vendim për përjashtimin e tyre nga ekipi përfaqësues. Këshilli për Çështje Emergjente beson se kjo masë do të ndikojë te këta futbollistë dhe te të tjerët që të kenë kujdes kur veshin fanellën e përfaqësueses së Kosovës dhe mbrojnë ngjyrat e shtetit të Kosovës", thuhet në njoftimin e FFK-së.



# KOK-u mbështet ekipin olimpik të xhudos me vijimin e kampeve në Herstal dhe Paris




PRISHTINË, 5 SHKURT - Ekipi Olimpik i Xhudos po vijon përgatitjet para garës së Grand Slamit që mbahet më 8 dhe 9 shkurt 2020 në Paris të Francës. Për t'u përgatitur sa më mirë për këtë garë dhe të tjerat që i presin në rrugën e gjatë drejt kualifikimit për në Lojërat Olimpike "Tokio 2020", ekipi i xhudos po merr pjesë në kampin Herstal të Belgjikës që po mbahet prej 2-7 shkurt 2020.
Komiteti Olimpik i Kosovës është duke vazhduar mbështetjen për ekipin olimpik të xhudos, duke i mbuluar shpenzimet e pjesëmarrjes në këtë kamp, bazuar në vendimin e Bordit Ekzekutiv të KOK-ut për t'i mbështetur sportistët elitarë. "Krahas këtij kampi, xhudo do të vazhdojë edhe me kampin tjetër në Paris, që mbahet prej 9-13 shkurtit 2020, shpenzimet e të cilëve sërish mbulohen nga KOK-u", thuhet në njoftimin e Komitetit Olimpik.
Gara e madhe e Grand Slamit të Parisit mbahet këtë fundjavë, ku sportistët tanë synojnë të ngjiten në podium dhe të fitojnë sa më shumë pikë olimpike për Lojërat Olimpike "Tokio 2020". Sipas përzgjedhësit të xhudos, Driton Kuka, në Paris do të marrin pjesë Majlinda Kelmendi, Nora Gjakova e Distria Krasniqi, kurse ende nuk dihet nëse do të përfaqësohet edhe Laura Fazliu. Deri më tani të pesë xhudistët Majlinda Kelmendi (-52 kg), Nora Gjakova (-57 kg), Distria Krasniqi (-48 kg), Loriana Kuka (-78 kg) dhe Akil Gjakova (-73 kg) janë brenda normës olimpike.

# Lakersat vazhdojnë dominimin në Perëndim, Milwaukee në Lindje

LOS ANXHELOS, 5 SHKURT - Ekipi i Lakersit vijon të dominojë në renditjen në Konferencën e Perëndimit, duke triumfuar me rezultat 129-102 ndaj San Antonios. Ndeshje e dominuar nga Lakersat, ku u dallua LeBron James, autor i 36 pikëve, më i miri në parket. Fitoi edhe skuadra e Denverit, e cila e mposhti me rezultat 127-99 Portlandin, duke qëndruar në elitën e skuadrave në Perëndim. Për Denverin u dallua Jokiq, që realizoi 29 pikë e 13 rebounde. Në Lindje vazhdon të dominojë skuadra e Milwaukees, që triumfoi me rezultat 120-108 në fushën e New Orleansit. Ndeshje më e mirë për vendësit në pjesën e parë, ku u dallua Ingram me 32 pikë, ndërsa në pjesën e dytë erdhi përmbysja e Bucksit me Antetokounmpo, që realizoi 34 pikë e 17 rebounde, raporton "Telesport". Fiton edhe Houstoni, me rezultat 125-110 ndaj Charlottes, me Hardenin protagonist, autor i 40 pikëve dhe 10 asistimeve.

**REZULTATET**

| | |
|---|---|
| New Orleans - Milwaukee | 108-120 |
| Houston - Charlotte | 125-110 |
| Denver - Portland | 127-99 |
| Lakers - San Antonio | 129-102 |



## SHKURT

### Verstappeni: Mund ta mposhti Hamiltonin

Në prag të fillimit të sezonit të ri në Formula 1, piloti holandez i Red Bullit, Max Verstappen, i ka lëshuar sfidën kampionit të botës, britanikut të Mercedesit, Lewis Hamilton. Talenti 22-vjeçar holandez mendon se ky është viti i duhur për të treguar se mund të shpallet kampion bote, edhe pse pranon që ka nevojë për një makinë të shpejtë. "Lewisi është një pilot i mirë, një nga më të mirët në qarkullim, por ai nuk është Zot. Ndoshta Zoti është me të në krah, por ai nuk është Zoti", ka thënë Verstappen, që u shpreh se mund ta mposhtë rivalin britanik: "Sigurisht se e mund në pistë. Me një makinë të mirë e realizoj këtë gjë. Ky është një sport ku fitorja varet nga makina".

### Mançini: Ka përfunduar koha e mbrojtjes, Italia tash luan futboll sulmues

Trajneri i Italisë, Roberto Mançini, ka thënë se skuadra e tij do të luajë futboll tërheqës, pasi ka përfunduar koha e mënyrës klasike të futbollit italian. I pyetur për identitetin e kombëtares italiane, Mançini shprehet se mënyra e vjetër e të bërit të gjërave ka përfunduar. "Më pëlqen futbolli sulmues, e di që kemi fituar katër Kupa të Botës duke luajtur në mënyrën italiane, por mendoj se mund të luajmë sot një futboll më sulmues. Ditët e lojës së futbollit mbrojtës dhe kundërsulmues kanë mbaruar", ka thënë fillimisht Mançini. "Jemi krenarë që kemi rindërtuar dashurinë e italianëve për kombëtaren dhe në Kampionatin Evropian në qershor do të përpiqemi t'i bëjmë të lumtur tifozët tanë. Futbolli është një faktor uniteti, nëse kombëtarja italiane luan mirë dhe Italia fiton, ata janë të lumtur. Kur dëgjoj himnin kombëtar nga bankina, ndihem krenar dhe i lumtur që jam italian. Besoj se vendi ynë është më i bukuri në botë. Jetojmë në mes të bukurisë. Askush nuk ka thesaret artistike dhe mjedisore që kemi", ka deklaruar Mançini.

### Barça ëndërron transferimin e Martinezit

Sulmuesi i Interit, Lautaro Martinez, është shndërruar në ëndrrën e madhe të Barcelonës për verën e ardhshme. Ylli argjentinas ka pasur një sezon të mirë nën drejtimin e Antonio Contes, ku në 20 paraqitje në Serinë A ka shënuar 11 gola. Te Barcelona janë duke shpresuar në një dështim për nënshkrim të kontratës së re mes Interit dhe Lautaros. Në kontratën aktuale të Lautaros me Interin ekziston një klauzolë që në muajin korrik i mundëson largimin për 111 milionë euro. Kampionët e La Ligas do të ishin të gatshëm ta paguanin këtë shumë për Lautaron, si një zëvendësim të denjë për Luis Suarezin.

### Ronaldo mbush 35 vjet: Mund të luaj deri në moshën 40-vjeçare

